



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

RAPORTI VJETOR 2024 PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR. 05/L - 021 PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

Prishtinë, 10 dhjetor 2025

PËRMBAJTJA

FJALA E AVOKATIT TË POPULLIT.....	5
I. KORNIZA LIGJORE PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI NË REPUBLIKËN E KOSOVËS	6
<i>Kushtetuta e Republikës së Kosovës</i>	<i>7</i>
<i>Ligji Nr. 05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi.....</i>	<i>7</i>
<i>Procedurat ligjore për mbrojtjen nga diskriminimi</i>	<i>8</i>
II. MEKANIZMAT INSTITUCIONALË PËR MBIKËQYRJEN E ZBATIMIT TË LIGJIT PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI	9
<i>Avokati i Popullit.....</i>	<i>10</i>
<i>Zyra për Qeverisje të Mirë</i>	<i>10</i>
<i>Mekanizmat institucionalë për mbrojtjen nga diskriminimi në ministri dhe komuna</i>	<i>11</i>
III. ROLI I INSTITUCIONEVE TË TJERA.....	11
<i>Agjencia për Barazi Gjinore</i>	<i>11</i>
<i>Zyra e Komisionarit për Gjuhët.....</i>	<i>11</i>
<i>Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil.....</i>	<i>12</i>
<i>Inspektorati i Punës</i>	<i>12</i>
<i>Inspektorati i Arsimit</i>	<i>13</i>
<i>Inspektorati Shëndetësor</i>	<i>13</i>
IV. KOMPETENCAT KUSHTETUESE DHE LIGJORE TË AVOKATIT TË POPULLIT PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI.....	13
<i>Rastet e trajtuara nga Avokati i Popullit për mbrojtje nga diskriminimi gjatë vitit 2024.....</i>	<i>14</i>
<i>Raportet lidhur me rastet e hetuara sipas detyrës zyrtare (ex officio)</i>	<i>14</i>
<i>Raportet me rekomandime lidhur me rastet individuale</i>	<i>17</i>
<i>Opinione</i>	<i>18</i>
<i>Kërkesat kushtetuese</i>	<i>21</i>
<i>Aktivitete promovuese lidhur me barazinë</i>	<i>22</i>
V. TË GJETURAT E AVOKATIT TË POPULLIT NË ROLIN MBIKËQYRËS NË ZBATIMIN E LIGJIT PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI	22
<i>Grumbullimi i të dhënave lidhur me Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi</i>	<i>22</i>
VI. TË GJETURAT E AVOKATIT TË POPULLIT LIDHUR ME DISKRIMINIMIN.....	26
VII. REKOMANDIMET.....	29

LISTA E SHKURTESAVE

ABGj - Agjencia për Barazi Gjinore
AIP - Agjencia për Informim dhe Privatësi
AK - Autoriteti i Konkurrencës
AKKVP - Agjencia Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës
AKP - Agjencia Kosovare e Privatizimit
AMM - Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit
ANJF - Agjencia për Ndihmë Juridike Falas
AP - Avokati i Popullit
APK - Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit
ASK - Agjencia e Statistikave të Kosovës
BE – Bashkimi Evropian
BQK - Bankës Qendrore e Kosovës
FSK - Forca e Sigurisë së Kosovës
GjEDNj - Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut
GjK - Gjykata Kushtetuese
KEDNj - Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut
KGjK - Këshilli Gjyqësor i Kosovës
KiE - Këshilli i Evropës
KKTK - Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturor
KPK - Këshilli Prokurorial i Kosovës
KPM - Komisioni i Pavarur i Mediave
KPM - Komisioni i Pavarur për Miniera e Minerale
KPMShC - Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil
KQZ - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
LBGj - Ligji për Barazi Gjinore
LMD - Ligji për Mbrojtje nga Diskriminimi
MAPL - Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
MASHTI - Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
MBPZhR - Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
MD - Ministria e Drejtësisë
MFPT - Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
MINT - Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
MKK - Ministria për Komunitete dhe Kthim
MKRS - Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
MM - Ministria e Mbrojtjes
MMPHI - Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
MPB - Ministria e Punëve të Brendshme
MPJD - Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës
ME - Ministria e Ekonomisë
MSh - Ministria e Shëndetësisë
MZhR - Ministria e Zhvillimit Rural
OSHP - Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik
PK – Policia e Kosovës
RTK - Radiotelevizioni i Kosovës
SMIL - Sistemi për Menaxhimin Informativ të Lëndëve

TKP - Trusti i Kursimeve Pensionale.

ZKA - Zyra Kombëtare e Auditimit

ZKGj - Zyra e Komisionarit për Gjuhët, në kuadër të Zyrës së Kryeministrit

ZQM - Zyra për Qeverisje të Mirë, në kuadër të Zyrës së Kryeministrit

FJALA E AVOKATIT TË POPULLIT

Ky është viti i dytë që Avokati i Popullit ia paraqet Kuvendit të Republikës së Kosovës Raportin për zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Me paraqitjen e këtij raporti, Avokati i Popullit jo vetëm që përmbush një detyrim të përcaktuar me nenin 9 të Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, por njëkohësisht dëshmon përkushtimin e tij për promovimin dhe garantimin e së drejtës për barazi para ligjit dhe mbrojtjes nga diskriminimi.

Është me rëndësi të theksohet se publikimi i këtij raporti përkon me procesin e ndryshimit dhe plotësimit të Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, i cili parashihet të jetë pjesë e agjendës legjislative të Kuvendit të Republikës së Kosovës gjatë vitit 2026. Avokati i Popullit luajti dhe vazhdon të luajë një rol aktiv në të gjitha fazat e këtij procesi.

Barazia para ligjit dhe mbrojtja nga diskriminimi përbëjnë vlera kushtetuese në Republikën e Kosovës. Sistemi juridik i vendit ofron garanci të fuqishme kundër çdo forme të diskriminimit, duke mbrojtur të gjithë qytetarët dhe grupet shoqërore, pa dallim. Nenet 3 dhe 24 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, së bashku me Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, përbëjnë shtyllat kryesore të kësaj mbrojtjeje. Ndërkaq, neni 53 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës obligon gjykatat dhe institucionet publike që të drejtat dhe liritë themelore të njeriut t'i interpretojnë në harmoni me jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Kjo përfshin edhe të drejtën për barazi para ligjit dhe mbrojtjen nga diskriminimi, e cila, sipas kësaj gjykate, qëndron në themel të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Megjithatë, zbatimi i garancive kushtetuese dhe ligjore mbetet një sfidë institucionale dhe shoqërore. Mungesa e mekanizmave të konsoliduar institucionalë dhe procedurave të standardizuara për identifikimin dhe evidentimin e rasteve të diskriminimit vështirësojnë krijimin e një pasqyre të qartë dhe gjithëpërfshirëse të diskriminimit.

Avokati i Popullit mbetet i përkushtuar ndaj përmbushjes së mandatit të tij kushtetues dhe ligjor në mbrojtjen nga diskriminimi. Duke u mbështetur në gjetjet dhe rekomandimet e raportit të vitit të kaluar, ritheksojmë angazhimin tonë për rritjen e vetëdijes publike dhe forcimin e kapaciteteve institucionale për identifikimin, trajtimin dhe parandalimin e rasteve të diskriminimit nga institucionet publike.¹ Përkushtimi ynë për të garantuar barazinë para ligjit dhe mbrojtjen nga çdo formë të diskriminimit do të vazhdojë të thellohet, sepse këto vlera përfaqësojnë themelet e shtetit dhe shoqërisë sonë demokratike.

Në fund, dëshiroj të theksoj se ky raport ofron një pasqyrë të qartë të kornizës ligjore, strukturës institucionale, sfidave dhe dinamikave që lidhen me realizimin e së drejtës për barazi dhe mbrojtjen nga diskriminimi. Njëkohësisht, ai synon të nxisë një nivel më të lartë vetëdijeje institucionale dhe shoqërore mbi rëndësinë e garantimit të kësaj të drejte themelore.

¹ Raportin për Zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi 2023 e gjeni në: <https://oik-rks.org/2024/12/10/raporti-vjetor-2023-per-zbatimin-e-ligjit-per-mbrojtje-nga-diskriminimi/>

I. KORNIZA LIGJORE PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

Nisur nga mandati kushtetues për mbikëqyrjen dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të individëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike, Avokati i Popullit ka një rol qendror në mbrojtjen nga diskriminimi dhe promovimin e së drejtës për barazi para ligjit. Ligji për Avokatin e Popullit përcakton se ai është një mekanizëm i barazisë për promovimin, monitorimin dhe mbështetjen e trajtimit të barabartë, pa diskriminim. Veprimtaria e Avokatit të Popullit për realizimin e këtij funksioni shtrihet në disa drejtime, duke përfshirë zhvillimin e hetimeve në rast të ankesave të personave fizikë dhe juridikë që pretendojnë se janë diskriminuar; zhvillimin e hetimeve me vetiniciativë (ex officio) për raste të diskriminimit dhe paraqitjen e raporteve për to; pjesëmarrjen në cilësinë e mikut të gjykatës (amicus curiae) në proceset gjyqësore që lidhen me diskriminimin; si dhe dhënien e rekomandimeve dhe kryerjen e aktiviteteve promovuese për rritjen e vetëdijes mbi barazinë para ligjit dhe mbrojtjen nga diskriminimi.

Krahas këtyre detyrave dhe përgjegjësi, sipas Nenit 9 të Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi (LMD), Avokati i Popullit mbikëqyr zbatimin e këtij ligji. Paragrafi 2.12 i Nenit 9 i kërkon Avokatit të Popullit të paraqesë të paktën një raport në vit në Kuvendin e Republikës së Kosovës mbi zbatimin e LMD-së. Në zbatim të këtij detyrimi, që nga viti i kaluar, Avokati i Popullit filloi paraqitjen e raporteve vjetore të veçanta në Kuvend mbi zbatimin e LMD-së. Duhet theksuar se Avokati i Popullit paraqiti gjithashtu raporte të rregullta vjetore për aktivitetet e tij, të cilat përfshijnë informacione të përgjithshme dhe të dhëna mbi rastet e diskriminimit të trajtuara nga ky institucion.

Raporti Vjetor për Zbatimin e LMD-së për vitin 2024 shënon raportin e dytë vjetor që Avokati i Popullit ia paraqet Kuvendit të Republikës së Kosovës, në bazë të Nenit 9, paragrafi 2.12, të LMD-së. Ashtu si vitin e kaluar, përgatitja e këtij raporti u mbështet nga Këshilli i Evropës (KiE).

Ky raport bazohet në përvojën e hartimit të Raportit të vitit paraprak, si dhe në gjetjet kryesore dhe rekomandimet e tij. Në mënyrë të veçantë, u mor në konsideratë mungesa e informacioneve dhe e të dhënave mbi rastet e diskriminimit nga institucionet gjegjëse, të cilave u është drejtuar Avokati i Popullit. Së këndejmi, krahasuar me raportin e vitit të kaluar, këtë vit numri i institucioneve dhe i organizatave nga të cilat u kërkuar informacion për rastet e diskriminimit u rrit dukshëm. Mbledhja e të dhënave u bë duke u mbështetur në një tabelë të dizajnuar për të mbledhur të dhëna sasiore dhe cilësore, të nevojshme për të vlerësuar zbatimin e LMD-së.

Republika e Kosovës ka një kornizë të konsoliduar ligjore për mbrojtjen nga diskriminimi, e cila përfshin standardet më të larta të garantuara nga aktet juridike ndërkombëtare, veçanërisht Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNj), si dhe aktet e tjera të Këshillit të Evropës (KiE) dhe të Bashkimit Evropian (BE).

Dy aktet kryesore legjislative që garantojnë barazinë para ligjit dhe mbrojtjen nga diskriminimi janë Kushtetuta dhe LMD-ja. Përveç tyre, një spektër i gjerë ligjesh dhe aktesh nënligjore siguron barazinë para ligjit dhe mbrojtjen nga diskriminimi, duke shtrirë mbrojtjen në fusha të veçanta. Kjo përfshin Ligjin për Barazi Gjinore, Ligjin e Punës, Ligjin për Zyrtarët Publikë, Ligjin për Arsimin Parauniversitar, Ligjin për Arsimin e Lartë, Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe një varg ligjesh të tjera materiale dhe

procedurale. Këto akte normative përcaktojnë procedurat që duhet të ndjekin personat fizikë dhe juridikë për të kërkuar mbrojtje nga diskriminimi dhe kompensim në rast se janë viktime të tij.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Kushtetuta e Republikës së Kosovës i jep së drejtës për barazi para ligjit dhe mbrojtjes nga diskriminimi një status të dyfishtë. Së pari, e drejta për barazi para ligjit dhe ndalimi i diskriminimit sanksionohet si parim themelor kushtetues në Kapitullin I të Kushtetutës [Dispozitat Themelore], konkretisht në nenet 3 dhe 7. Së dyti, barazia para ligjit dhe mbrojtja nga diskriminimi garantohen si të drejta individuale kushtetuese në Kapitullin II [Të Drejtat dhe Liritë Themelore], përkatësisht në nenin 24.

Përveç kësaj, mbrojtja nga diskriminimi mbështetet edhe në Nenin 22 të Kushtetutës [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], i cili parashikon se disa nga këto instrumente ndërkombëtare, të cilat janë pjesë përbërëse e rendit juridik të Kosovës, përmbajnë dispozita që ndalojnë diskriminimin.

Po ashtu, Neni 53 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës i detyron gjykatat dhe të gjitha institucionet e Republikës që të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë - përfshirë edhe të drejtën për barazi para ligjit - të interpretohen në harmoni me vendimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNj).

Ligji Nr. 05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi

Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi paraqet *lex specialis* në çështjet e diskriminimit dhe, si i tillë, ka një rol qendror në trajtimin e rasteve që lidhen me diskriminimin. Kësisoj, përveç Kushtetutës, ky ligj përbën aktin kryesor normativ, mbi bazën e të cilit adresohen rastet e diskriminimit, si në procedura administrative, ashtu edhe në ato gjyqësore. Mbrojtja juridike që ofron ky ligj plotësohet gjithashtu nga dispozita të veçanta të ligjeve sektoriale, të cilat rregullojnë fusha të tilla, si: arsimi, shëndetësia, punësimi dhe administrata publike.

Ky ligj vendos një kornizë të përgjithshme normative për parandalimin dhe luftimin e të gjitha formave të diskriminimit, duke garantuar gjithashtu të drejtën për barazi para ligjit për të gjithë personat fizikë dhe juridikë që janë nën autoritetin e institucioneve shtetërore të Republikës së Kosovës.

LMD-ja ofron garanci gjithëpërfshirëse kundër diskriminimit, duke përfshirë një listë të gjerë dhe joshteruese të bazave të mbrojtura. Në këtë kontekst, Neni 1, paragrafi 1, thekson qëllimin e ligjit për të parandaluar dhe luftuar diskriminimin mbi baza të tilla, si: kombësia ose lidhja me ndonjë bashkësi, prejardhja shoqërore ose kombëtare, raca, etnia, ngjyra, lindja, prejardhja, seksi, gjinia, identiteti gjinor, orientimi seksual, gjuha, shtetësia, besimi fetar dhe besimi, përkatësia politike, mendimi politik ose mendimet e tjera, gjendja sociale ose personale, mosha, gjendja familjare ose martesore, shtatzënia, lehonja, gjendja pasurore, gjendja shëndetësore, aftësia e kufizuar, trashëgimia gjenetike, ose ndonjë bazë tjetër.

Ky ligj zbatohet si në sektorin publik, ashtu edhe në atë privat, dhe përmban përkufizime shumë gjithëpërfshirëse të formave të ndryshme të diskriminimit, duke përfshirë diskriminimin e drejtpërdrejtë, diskriminimin e tërthortë, ngacmimin, nxitjen për të diskriminuar, viktimizimin, segregacionin, diskriminimin në bazë të asociimit, mosdhënien e një përshtatjeje/akomodimi të arsyeshëm për personat me aftësi të kufizuara, diskriminimin në bazë të perceptimit, si dhe diskriminimin e shumëfishtë.

Ligji përcakton në mënyrë të qartë përgjegjësinë institucionale për zbatimin e tij, si në nivel qendror, ashtu edhe në atë lokal, ku rol dhe prerogativa të veçanta i janë besuar Avokatit të Popullit. Ai përmban gjithashtu procedura të veçanta për zbatimin e tij, të përmbledhura në Kreun II, të cilat përcaktojnë mënyrat konkrete të mbrojtjes nga diskriminimi në praktikë.

Duhet theksuar se LMD-ja është në proces të plotësimit dhe ndryshimit, që është paraprirë nga Raporti për Vlerësimin *Ex-Post* të Zbatimit të LMD-së, të përgatitur nga Zyra Ligjore e Zyrës së Kryeministrit, me pjesëmarrjen e aktorëve kryesorë institucionalë në fushën e mbrojtjes nga diskriminimi, përfshirë edhe Avokatin e Popullit. Gjatë vitit 2024, grupi ndërinstitutional përfundoi draftin e ri të Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Ky Projektligj pritet të vihet në agjendën legislative të Kuvendit të Republikës së Kosovës në vitet e ardhshme. Drafti i ri i ligjit thekson procedurat administrative dhe gjyqësore për zbatimin e tij, si dhe bashkëpunimin ndërinstitutional për zbatimin e dispozitave ligjore që lidhen me mbrojtjen nga diskriminimi.

Kur bëhet fjalë për direktivat e BE-së, është e rëndësishme të theksohet se BE-ja në vitin 2024 miratoi Direktivën 2024/1499² dhe Direktivën 2024/1500,³ të cilat vendosin një grup standardesh minimale dhe të detyrueshme për funksionimin e trupave të barazisë. Këto direktiva përqendrohen në forcimin e pavarësisë institucionale, garantimin e burimeve të mjaftueshme, zgjerimin e mandatit dhe krijimin e mekanizmave efektivë për trajtimin e rasteve të diskriminimit. Ato përcaktojnë se organet e barazisë duhet të kenë kompetenca të qarta për të mbështetur viktimat, për të hetuar rastet, për të marrë pjesë në procese gjyqësore dhe për të ofruar rekomandime për politika, duke siguruar njëkohësisht transparencë dhe qasje të lehtë të publikut në shërbimet e tyre.

Këto direktiva synojnë eliminimin e mospërputhjeve që kanë ekzistuar mes vendeve të ndryshme të BE-së dhe krijimin e një niveli të barabartë mbrojtjeje kundër diskriminimit, duke siguruar që çdo qytetar të ketë qasje në një mekanizëm efektiv, të pavarur dhe të fuqizuar ligjërisht.

Megjithëse Republika e Kosovës ka një legjislacion të konsoliduar në lidhje me mbrojtjen nga diskriminimi, ky është një moment i përshtatshëm për të përditësuar kuadrin ligjor në përputhje me këto dy direktiva të BE-së. Kjo është veçanërisht e rëndësishme duke marrë parasysh se LMD-ja tashmë është në proces ndryshimi dhe se harmonizimi me standardet e reja do të siguronte një qasje më të avancuar dhe më funksionale. Qëllimi i plotësimit dhe ndryshimit të LMD-së është përshtatja e ligjit për t'iu përgjigjur sfidave, nevojave dhe transformimeve shoqërore, si dhe harmonizimi i tij me standardet në zhvillim të Këshillit të Evropës dhe *acquis* të BE-së. Transpozimi i këtyre dy direktivave, të cilat tashmë kanë hyrë në fuqi, kontribuon drejtpërdrejt në përmbushjen e qëllimit të iniciativës për ndryshim dhe plotësim të LMD-së.

Procedurat ligjore për mbrojtjen nga diskriminimi

Legjislacioni i Republikës së Kosovës ofron mbrojtje të shumëfishtë për personat që pretendojnë se janë diskriminuar. Kjo mund të realizohet përmes procedurave të natyrës administrative, kundërvajtëse ose gjyqësore. Përmes këtyre mjeteve, të dëmtuarit mund të kërkojnë mbrojtje, sanksion për shkelësit dhe kompensim dëmi.

² https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/HTML/?uri=OJ:L_202401499

³ https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/HTML/?uri=OJ:L_202401500

Përveç këtyre procedurave tipike juridike, të cilat janë paraqitur në vijim, duhet theksuar se Neni 21 i LMD-së parasheh se rastet e diskriminimit mund të trajtohen edhe me ndërmjetësim apo pajtim, siç parashihet me legjislacionin aktual.

Procedura administrative - Të gjitha institucionet, qoftë në nivel lokal apo qendror, detyrohen të zbatojnë legjislacionin për mbrojtje nga diskriminimi. Secilën herë kur pretendohet se ka trajtim diskriminues, hapi i parë mund të jetë ankesa administrative brenda institucionit që pretendohet se shkaktoi shkeljen, ose që ka përgjegjësi për të sanuar shkeljen, si në nivel lokal (komunë), ashtu edhe në nivel qendror (të gjitha institucionet qendrore, duke përfshirë edhe agjencitë e pavarura).

Procedura kundërvajtëse – LMD-ja përmban “Dispozita kundërvajtëse”, nëpërmjet të cilave përcaktohen sanksione për personat fizikë dhe juridikë, të cilët veprojnë në kundërshtim me këtë ligj. Ai gjithashtu përcakton bazat për fillimin e procedurave për kundërvajtje, duke përfshirë shqiptimin e gjobave ndaj individëve, personave juridikë dhe institucioneve publike që kryejnë, nxisin ose mbështesin aktivitete diskriminuese. Ligji autorizon Avokatin e Popullit që të kërkojë nga organet kompetente fillimin e procedurave kundërvajtëse për diskriminim. Procedura kundërvajtëse për diskriminim mund të iniciohet në gjykatë, apo edhe në organet administrative (siç mund të jenë inspektoratet e ndryshme).

Procedura gjyqësore - Në rastet e diskriminimit, mund të iniciohen procedura të ndryshme gjyqësore, si: padi civile për kompensimin e dëmit; padi për konflikt administrativ ndaj veprimeve ose mosveprimeve të organeve administrative që përmbajnë elemente diskriminuese; si dhe procedura penale përmes ngritjes së kallëzimit penal, nëse akti i diskriminimit përbën veprën penale të “shkeljes së statusit të barabartë të qytetarëve dhe banorëve të Republikës së Kosovës” ose lidhet me veprën penale të nxitjes së përçarjes, urrejtjes dhe mosdurimit. Gjithashtu, ngacmimi seksual, përveçse konsiderohet formë e diskriminimit sipas Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me Kodin Penal të Republikës së Kosovës sanksionohet si vepër penale kundër jetës dhe trupit.

Procedura te Avokati i Popullit - Avokati i Popullit paraqet mekanizmin kushtetues për mbrojtjen, mbikëqyrjen dhe promovimin e të drejtave dhe lirive themelore të personave fizikë dhe juridikë nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike, institucioneve dhe personave apo autoriteteve të tjera, që ushtrojnë autorizime publike në Republikën e Kosovës. Gjithashtu, Avokati i Popullit është mekanizëm i barazisë për promovim, monitorim dhe mbështetje të trajtimit të barabartë pa diskriminim në bazat e mbrojtura nga Ligji për Barazi Gjinore dhe Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

II. MEKANIZMAT INSTITUCIONALË PËR MBIKËQYRJEN E ZBATIMIT TË LIGJIT PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Fillimisht, duhet bërë dallimi ndërmjet detyrimit ligjor për zbatimin e LMD-së dhe detyrimit ligjor për mbikëqyrjen e zbatimit të tij. Në aspektin e parë, barazia para ligjit dhe mbrojtja nga diskriminimi përbëjnë parime kushtetuese dhe të drejta themelore individuale. Për këtë arsye, çdo institucion publik ka detyrimin kushtetues dhe ligjor të respektojë këto parime, gjë që përfshin edhe zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Nenin 2, paragrafi 1, i LMD-së thekson se dispozitat e tij vlejnë për çdo veprim apo mosveprim të të gjitha institucioneve shtetërore, si dhe të personave fizikë e juridikë në

sektorin publik dhe privat. Ndërsa Neni 8 thekson se të gjitha institucionet detyrohen të veprojnë në përputhje me parimet e këtij ligji.

Së këndejmi, zbatimi i LMD-së është detyrim i përbashkët ndërmjet një sërë mekanizmash institucionalë. Ndërsa përgjegjësia për mbikëqyrjen e zbatimit të tij i është caktuar vetëm një numri të kufizuar organesh.

Përderisa zbatimi i LMD-së ka për qëllim të garantojë jetësimin në praktikë të së drejtës kushtetuese të personave për mbrojtje nga diskriminimi në të gjitha fushat e ndryshme të jetës, mbikëqyrja është një aktivitet institucional në funksion të garantimit të zbatimit të duhur të kornizës ligjore gjegjëse. Mbikëqyrja mëton të identifikojë, me ndihmën e treguesve specifikë, nivelin e të kuptuarit të detyrimeve ligjore që rrjedhin nga LMD-ja dhe respektimin e tyre nga aktorë të ndryshëm, me qëllim identifikimin e fushave ku nevojiten përmirësime.

LMD-ja parashikon mekanizma institucionalë dhe procedura të posaçme për mbikëqyrjen sistematike të zbatimit të tij. Edhe pse ligji ngarkon me përgjegjësi të drejtpërdrejtë një numër të kufizuar institucionesh dhe zyrtarësh, mbikëqyrja e zbatimit të tij nuk mund të realizohet pa një bashkëpunim të strukturuar dhe sistematik ndërinstitucional.

Avokati i Popullit

Sipas Nenit 132, paragrafi 1, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Avokati i Popullit mbikëqyr dhe mbron të drejtat e individëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme të autoriteteve publike. Mandati i tij përcaktohet më tej në Ligjin për Avokatin e Popullit, me Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi (LMD) dhe me Ligjin për Barazi Gjinore (LBGj).

Kompetencat e Avokatit të Popullit në zbatimin e LMD-së parashihen në nenet 9, 12 dhe 18 të ligjit. Sipas Nenit 9, paragrafi 2, pika 2.1, Avokati i Popullit pranon, heton dhe ndërmjetëson në parastresat për diskriminim, si dhe jep mendime dhe rekomandime. Neni 9, paragrafi 2, pika 2.6, e obligon atë të përcjellë zbatimin e LMD-së dhe të nxisë ndryshimet e nevojshme ligjore. Ndërsa pika 2.12 e detyron të raportojë çdo vit në Kuvend për zbatimin e ligjit.

Rolet plotësuese të Avokatit të Popullit në fushën e mbrojtjes nga diskriminimi përcaktohen në Nenin 16 dhe Nenin 18 të LMD-së. Në këtë kuadër, Departamenti për Mbrojtjen nga Diskriminimi luan rol qendror në mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit.

Përmes këtij raporti, Avokati i Popullit paraqet gjetjet mbi rastet e diskriminimit, vlerësimet e tij si mekanizëm mbikëqyrës i zbatimit të LMD-së dhe disa nga aktivitet promovuese lidhur me barazinë.

Zyra për Qeverisje të Mirë

Zyra për Qeverisje të Mirë (ZQM), që funksionon në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, ka rol qendror dhe koordinues në zbatimin e LMD-së nga ana e Qeverisë. Ajo këshillon Qeverinë në çështjet e barazisë, siguron që politikat dhe projektligjet të jenë në përputhje me standardet e të drejtave të njeriut dhe monitoron zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit. ZQM-ja harton politika dhe plane veprimi, mbledh të dhëna dhe kryen studime për grupet e ndjeshme, si dhe çdo vit i raporton Qeverisë për zbatimin e LMD-së.

Si mekanizëm koordinues, ZQM-ja udhëheq procesin e bashkëpunimit me ministrinë dhe komunitat, të cilat obligohen të caktojnë zyrtarë për zbatimin e LMD-së. Ajo gjithashtu propozon aktet nënligjore që përcaktojnë mënyrën e raportimit dhe koordinimit institucional.

Përveç kësaj, ZQM-ja bashkëpunon me organizatat ndërkombëtare dhe mbështet Qeverinë në krijimin e partneriteteve me organizata joqeveritare për avancimin e barazisë dhe luftimin e diskriminimit.

Mekanizmat institucionalë për mbrojtjen nga diskriminimi në ministri dhe komuna

Rol të rëndësishëm në mbikëqyrjen e zbatimit të LMD-së kanë edhe njësitë dhe zyrtarët për mbrojtjen nga diskriminimi në ministri dhe komuna.

LMD-ja, Neni 11, përcakton se të gjitha ministrinë dhe komunat obligohen të caktojnë njësinë apo zyrtarin përkatës. Ky mekanizëm institucional shtrin mbrojtjen nga diskriminimi në nivel qendror dhe lokal, përgjatë tërë strukturës institucionale shtetërore. Bazuar në Rregulloren nr.03/2017 për Mekanizmat Institucionalë për Mbrojtjen nga Diskriminimi në Qeveri dhe Komuna, në Nenin 5, paragrafi 2, përcakton se njësia apo zyrtari përkatës për mbrojtjen nga diskriminimi, në kuadër të ministrive dhe komunave, janë përgjegjës për bashkëpunim, koordinim, monitorim, raportim, mbrojtje, promovim të barazisë, mundësive të barabarta si dhe koordinimin e Strategjisë për Parandalimin dhe Luftimin e Diskriminimit, në pajtim me legjislacionin në fuqi apo me instrumentet ndërkombëtare që zbatohen në Republikën e Kosovës.

III. ROLI I INSTITUCIONEVE TË TJERA

Agjencia për Barazi Gjinore

Ligji Nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore (LBGj) është pjesë e pakos së ligjeve për të drejtat e njeriut në Kosovë, pako e cila përfshin Ligjin për Avokatin e Popullit dhe Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Ky ligj përcakton funksionin dhe rolin e Agjencisë për Barazi Gjinore (ABGj), e cila është një agjenci ekzekutive, që vepron në kuadër të Zyrës së Kryeministrit.

Ky ligj ndërlidhet ngushtë me LMD-në, i cili përcakton kuadrin e përgjithshëm për mbrojtjen e çdo individi nga çdo formë diskriminimi, pavarësisht bazës mbi të cilën ndodh – qoftë ajo gjinia, identiteti gjinor, orientimi seksual. Përderisa LMD-ja ka karakter të përgjithshëm dhe mbulon të gjitha format e diskriminimit, LBGj-ja fokusohet në barazinë gjinore, si komponent themelor i të drejtave të njeriut, duke forcuar mekanizmat institucionalë për zbatimin praktik të saj.

Në përputhje me nenin 8 të LBGj-së, ABGj-ja ka një sërë funksionesh dhe përgjegjësisish që synojnë promovimin dhe përforcimin e parimeve të barazisë gjinore. Ajo mbështet zbatimin e LBGj-së duke propozuar ndryshime ligjore, masa afirmative dhe politika të nevojshme për parandalimin e diskriminimit me bazë gjinore. ABGj-ja monitoron gjendjen e barazisë gjinore në institucionet publike, harton raporte analitike dhe ofron rekomandime. Po ashtu, agjencia bashkëpunon ngushtë me institucionet qeveritare dhe shoqërinë civile për të siguruar integritimin e perspektivës gjinore dhe për të avancuar të drejtat e grave dhe vajzave.

Zyra e Komisionarit për Gjuhët

Zyra e Komisionarit për Gjuhët, e themeluar në bazë të Ligjit Nr. 02/L-37 për Përdorimin e Gjuhëve, ka mandat të mbikëqyrë dhe sigurojë zbatimin e këtij ligji në gjithë territorin e Republikës së Kosovës. Roli i saj është të garantojë ruajtjen, promovimin dhe mbrojtjen e gjuhëve zyrtare, si dhe gjuhëve të komuniteteve, gjuha amtare e të cilave nuk është gjuhë zyrtare. Të gjitha institucionet publike obligohen të bashkëpunojnë me këtë Zyrë dhe t'i

dorëzojnë informacionet dhe raportet e nevojshme, ndërsa në secilin institucion caktohet një person kontaktues për çështjet e gjuhëve.

Zyra ka kompetencë të kryejë hetime me iniciativë të vet apo mbi bazën e ankesave nga persona fizikë apo juridikë, në rastet kur dyshohet për moszbatim të ligjit apo të akteve të tjera që rregullojnë përdorimin e gjuhëve. Ajo mund të ndërmarrë masa brenda kompetencës së saj, përfshirë ndërmjetësimin, me qëllim që institucionet të veprojnë në përputhje me ligjin. Përveç funksionit mbikëqyrës, Zyra e Komisionarit për Gjuhët mbështet Qeverinë në zbatimin e programeve të informimit publik, duke kontribuar që qytetarët të jenë të mirinformuar për të drejtat e tyre gjuhësore.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është organ i pavarur, që siguron respektimin e rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil sipas Kushtetutës dhe Ligjit përkatës për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës. Këshilli luan rol të rëndësishëm në funksion të vendosjes së drejtësisë administrative për mbrojtjen e të drejtave të zyrtarëve publikë nga trajtimet e padrejta, përfshirë diskriminimin në marrëdhënie pune. Po ashtu, është e rëndësishme të theksohet fakti se këshilli mbikëqyr zbatimin e dispozitave ligjore duke përfshirë edhe respektimin e plotësimin të kuotës së punësimit për grupet e nenpërfaqësuar në institucionet publike, të cilat mund të zbatohen masa afirmative, sipas legjislacionit përkatës për mbrojtjen nga diskriminimi.

Inspektorati i Punës

Inspektorati i Punës ka kompetencë për mbikëqyrjen e zbatimit të dispozitave të Ligjit të Punës, të cilat e rregullojnë marrëdhënien e punës, sigurinë dhe mbrojtjen në punë.

Sipas Nenit 5 të Ligjit të Punës, diskriminimi është rreptësisht i ndaluar në të gjitha aspektet e marrëdhënies së punës, përfshirë rekrutimin, trajnimin, avancimin, kushtet e punës, masat disiplinore dhe ndërprerjen e kontratës së punës. Kjo dispozitë përfshin ndalimin e çdo forme të diskriminimit të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, veçanërisht ndaj personave me aftësi të kufizuara, për aq kohë sa ata janë të aftë të kryejnë punën në mënyrë adekuate.

Në këtë kuadër, Inspektorati i Punës ka kompetenca të qarta për të monitoruar, hetuar dhe ndërmarrë masa ndaj çdo shkeljeje që lidhet me diskriminimin në vendin e punës. Inspektorët e punës janë të autorizuar të kryejnë inspektime të rregullta ose të jashtëzakonshme në institucionet publike dhe në sektorin privat, me qëllim të verifikimit të zbatimit të parimeve të barazisë dhe trajtimit të drejtë në marrëdhënien e punës.

Kur gjatë inspektimeve konstatohet se një punëdhënës ka vepruar në mënyrë diskriminuese, në fazën e konkursit, punësimit, trajtimit të punëtorëve apo ndërprerjes së kontratës – Inspektorati ka të drejtë të urdhërojë ndalimin e menjëhershëm të praktikave diskriminuese, të kërkojë korrigjimin e situatës dhe rivendosjen e trajtimit të barabartë, të propozojë masa ndëshkuese apo administrative sipas ligjit në fuqi.

Gjithashtu, Inspektorati i Punës ka rol parandalues dhe edukues, duke ofruar këshilla, trajnime dhe udhëzime për punëdhënësit e punëmarrësit lidhur me ndalimin e diskriminimit dhe zbatimin e standardeve të barazisë gjinore dhe profesionale.

Inspektorati i Tregut

Inspektorati i Tregut siguron që konsumatorët të mos diskriminohen në qasje dhe marrje të shërbimeve apo mallrave. Ai mbron konsumatorët nga praktikat diskriminuese dhe mbikëqyr ofruesit e shërbimeve për të garantuar trajtim të barabartë. Përmes monitorimit të standardeve në treg, Inspektorati kontribuon në parandalimin e diskriminimit ekonomik dhe social në shërbimet publike e private. Gjithashtu, është e rëndësishme që te shërbimet publike që i ofrohen konsumatorit, ofruesi i cili ofron shërbim publik përmes rrjetit të shpërndarjes duhet t'i lejojë konsumatorit qasje në rrjetin e shpërndarjes dhe të ofrojë shërbime në përputhje me rregulloret e veçanta, kontratat e koncesionit ose akteve të tjera të qeverisjes lokale në territorin e së cilës ofrohet shërbimi, me kushte jodiskriminuese.

Inspektorati i Arsimit

Inspektorati i Arsimit mbikëqyr respektimin e parimit të mosdiskriminimit në institucionet arsimore, duke trajtuar ankesat e nxënësve, prindërve, studentëve dhe stafit arsimor. Ai siguron qasje të barabartë në arsim, monitoron proceset e punësimit në arsim dhe ndërhyr kur vërehen praktika diskriminuese. Përmes këtij roli, Inspektorati promovon një sistem arsimor gjithëpërfshirës dhe të qasshëm për të gjithë.

Inspektorati Shëndetësor

Inspektorati Shëndetësor garanton që institucionet shëndetësore ofrojnë shërbime pa diskriminim, si për pacientët, ashtu edhe për stafin shëndetësor. Ai heton shkeljet, jep rekomandime profesionale dhe ndërmerr masa për trajtim të barabartë në qasjen dhe ofrimin e shërbimeve shëndetësore. Kontributi i tij është esencial për funksionimin e një sistemi shëndetësor gjithëpërfshirës dhe jodiskriminues.

Komisioni i Pavarur për Media (KPM)

Komisioni i Pavarur për Media është institucion i pavarur kushtetues, i cili është kompetent për rregullimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e spektrit të frekuencave të transmetimit. KPM-ja rregullon të drejtat, detyrimet, si dhe përgjegjësitë e personave fizikë dhe juridikë, të cilët ofrojnë shërbimet mediale audio dhe audiovizuale.

KPM-ja monitoron përmbajtjet audio dhe audiovizuale për të parandaluar shpërndarjen e materialeve që kanë të bëjnë me përdorimin e gjuhës nxitëse, fyese ose nënçmuese, ndërmerr masa ndaj shkeljeve dhe siguron që operatorët medialë të respektojnë standardet ligjore dhe etike të mosdiskriminimit.

IV. KOMPETENCAT KUSHTETUESE DHE LIGJORE TË AVOKATIT TË POPULLIT PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Avokati i Popullit është i vetmi institucion në Republikën e Kosovës që në mënyrë sistematike regjistron dhe mban të dhëna për rastet e diskriminimit. Sjellim në vëmendje se në Raportin e Avokatit të Populli lidhur me zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, dërguar Kuvendit më 11 dhjetor 2024, është konstatuar se përgjithësisht institucionet në Republikën e Kosovës nuk mbajnë të dhëna lidhur me ankesat dhe rastet e diskriminimit. Së këndejmi, për të dhënë një pasqyrë lidhur me zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Avokati i Popullit mbështetet në masë të madhe në të dhënat që vetë ky institucion i mban lidhur me ankesat e pranuar si dhe hetimet dhe analizat e zhvilluara me vetiniciativë.

Rastet e trajtuara nga Avokati i Popullit për mbrojtje nga diskriminimi gjatë vitit 2024

Gjatë viti 2024, Avokati i Popullit ka hetuar gjithsej 61 raste me pretendime për diskriminim, prej të cilave 41 janë hapur për hetim, ndërsa 20 janë shpallur të pabazuara. Gjithashtu kemi pranuar edhe kërkesa për këshillim apo ndihmë juridike. Numri më i madh i tyre kanë të bëjnë me pretendime për diskriminim sipas bazave të mbrojtja, si: E drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm; E drejta për mjete juridike; E drejta e punës dhe ushtrimit të profesionit; Mbrojtja shëndetësore dhe sociale; Mbrojtja e pronës; Barazia para ligjit; Eë drejtat e të akuzuarit; Të drejtat e fëmijës.

Gjatë periudhës raportuese janë hapur 9 raste sipas detyrës zyrtare (*ex officio*).

Ankesat që lidhen me pretendime për diskriminim përfshijnë kryesisht çështje që kanë të bëjnë me të drejtat shëndetësore e sociale, pensionet, marrëdhënien e punës, të drejtat e komuniteteve joshumicë, pengesat në ushtrimin e të drejtave për shkak të mosnjohjes së bashkësive fetare. Bazat mbi të cilat janë ngritur këto pretendime për diskriminim janë të ndryshme: aftësia e kufizuar, mosha, përkatësia etnike dhe fetare, statusi social, gjinia, orientimi seksual, gjendja shëndetësore, përkatësia politike dhe baza të tjera të mbrojtura sipas nenit 1 të LMD-së.

Nga gjithsej 14 raporte me rekomandime të publikuara mbi bazën e ankesave të pranura ose të hapura me iniciativë zyrtare, në 6 prej tyre është konstatuar shkelje e së drejtës për barazi para ligjit, përkatësisht diskriminim. Përveç kësaj, Avokati i Popullit ka publikuar dy opinione ligjore, në rolin e mikut të gjykatës (*amicus curiae*), si dhe një kërkesë në Gjykatën Kushtetuese – të gjitha të ndërlidhura me mosdiskriminimin.

Një prej aspekteve kryesore të punës së Avokatit të Popullit në garantimin e barazisë para ligjit dhe mbrojtjes nga diskriminimi mbetet vlerësimi i përputhshmërisë së akteve normative me nenet 3 dhe 24 të Kushtetutës dhe me Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Raportet lidhur me rastet e hetuara sipas detyrës zyrtare (ex officio)

Ex officio nr. 146/2021 gjuha në diskursin publik, në raport me detyrimet që ka shteti në garantimin e lirisë së shprehjes dhe parandalimin e gjuhës së urrejtjes⁴

Ky raport pati për qëllim tërheqjen e vëmendjes së publikut dhe të institucioneve lidhur me standardet ndërkombëtare dhe vendore mbi të drejtën e lirisë së shprehjes dhe konceptin e gjuhës së urrejtjes. Raporti synonte gjithashtu të kontribuonte në kuptimin e modeleve të diskursit të përdorur në mediat sociale dhe komunikimin publik në vend, duke analizuar forma të ndryshme të gjuhës së përdorur, si: gjuhën e urrejtjes, gjuhën diskriminuese, gjuhën fyese, retorikën që sfidon ide dhe besime, si dhe shprehjet që përfshijnë veprime negative jo të dhunshme, karakterizime fyese dhe çnjerëzore ndaj individëve apo grupeve të caktuara. Njëkohësisht, raporti synonte të rriste aftësinë e shoqërisë për të reaguar ndaj këtyre dukurive dhe për të zhvilluar narrative që promovojnë të drejtat e njeriut, diversitetin dhe tolerancën.

Avokati i Popullit vërejti se gjuha e përdorur në debatet publike nga politikanët pati ndikim të theksuar te publiku i gjerë, duke përcaktuar tematikën dhe tonin e diskursit publik. Në këtë kuadër, Avokati i Popullit këmbënguli në rëndësinë e rolit aktiv dhe përgjegjësisë së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në mbikëqyrjen e zbatimit të Kodit të Mirësjelljes nga

⁴ <https://oik-rks.org/2024/02/06/raport-ex-officio-nr-1462021-gjuha-ne-diskursin-publik-ne-raport-me-detyrimet-qe-ka-shteti-ne-garantimin-e-lirise-se-shprehjes-dhe-parandalimin-e-gjuhes-se-urrejtjes/>

subjektet politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatët, duke pasur si prioritet parandalimin e përdorimit të gjuhës së urrejtjes.

Gjatë periudhës së shqyrtuar, u konstatua mungesë e moderimit të mediave, të cilat ekspozonin publikun ndaj rasteve të gjuhës së urrejtjes pa kufizime dhe ndërhyrje. Më tej, Avokati i Popullit vërejti se Komisioni i Pavarur i Mediave nuk ndërmori veprime në kohë reale në monitorimin e vazhdueshëm të gjuhës së urrejtjes. Në këtë drejtim, u vlerësua e domosdoshme që KPM-ja të angazhohej në fushata të vazhdueshme kundër gjuhës së urrejtjes, me përfshirje të qasjes së publikut për ankesa dhe bashkëpunim të ngushtë me media dhe gazetarë për reagim të shpejtë dhe të efektshëm.

Në përfundim, Avokati i Popullit nënvizoi rëndësinë e rritjes së vetëdijes publike mbi pasojat e gjuhës së urrejtjes dhe ndikimin negativ të saj në shoqëri. Për këtë arsye, u apelua që të gjitha shtyllat e pushtetit, bashkë me organizatat profesionale dhe joqeveritare, të bashkëpunonin në rritjen e ndërgjegjësimit publik, identifikimin e praktikave më të mira dhe dënimin e qartë të gjuhës së urrejtjes dhe krimeve të urrejtjes, duke riafirmuar parimet e demokracisë, të sundimit të ligjit, të barazisë dhe të mosdiskriminimit.

Ex officio nr. 601/2023 në lidhje me detyrimet e shtetit për mbështetjen dhe ofrimin e shërbimeve të shëndetit mendor për personat e moshës mbi 65-vjeçare në Republikën e Kosovës⁵

Ky raport pati për qëllim analizimin dhe vlerësimin e detyrimeve dhe përgjegjësi të institucioneve shtetërore të Republikës së Kosovës në ofrimin e shërbimeve të shëndetit mendor për personat mbi 65 vjeç. Analiza synoi të hidhte dritë mbi aspektet kyçe që lidhen me disponueshmërinë, qasjen dhe cilësinë e këtyre shërbimeve, në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, legjislacionin në fuqi dhe standardet ndërkombëtare të zbatueshme në vend. Raporti synoi gjithashtu të identifikonte sfidat ekzistuese dhe të paraqiste rekomandime konkrete për përmirësimin e shërbimeve të shëndetit mendor për këtë grup-moshë, duke siguruar një qasje të barabartë dhe pa diskriminim për të gjithë.

Avokati i Popullit konstatoi se kufizimi i moshës deri në 65 vjeç si kriter për pranimin në institucionet rezidenciale përfaqësonte shkelje të dispozitave të Ligjit për Shërbime Sociale dhe Familjare, si dhe të Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi. Po ashtu, mungesa e akteve nënligjore të nevojshme për zbatimin e Ligjit për Shëndetin Mendor vështirësoi funksionalizimin e tij dhe krijoi hapësirë për praktika diskriminuese ndaj personave mbi 65 vjeç për qasje në shërbime.

Avokati i Popullit vërejti gjithashtu se, përveç mungesës së akteve të reja nënligjore, edhe mungesa e kriterëve të qarta në aktet ekzistuese, shfuqizimi i akteve nënligjore përmes vendimeve qeveritare pa nxjerrjen e akteve të reja, si dhe kufizimi i të drejtave të garantuara me ligj përmes akteve nënligjore, përbënin shkelje të drejtpërdrejtë të parimeve të sundimit të ligjit.

Ex officio nr. 535/2019 në lidhje me zbatimin e masave të veçanta të parapara me nenin 6 [Masat e veçanta] të Ligjit Nr.05/L-020 për Barazi Gjinore, nga ana e

⁵ <https://oik-rks.org/2024/09/10/raport-i-avokatit-te-popullit-ex-officio-nr-601-2023-ne-lidhje-me-detyrimet-e-shtetit-per-mbeshtetjen-dhe-ofrimin-e-sherbimeve-te-shendetit-mendor->

organeve legislative, ekzekutive dhe gjyqësore, në të gjitha nivelet, si dhe nga institucionet e tjera publike në Kosovë⁶

Avokati i Popullit, në cilësinë e organit të barazisë, me anë të këtij raporti pati për qëllim të pasqyrore gjendjen për sa i përket përfaqësimit gjinor në institucionet e Republikës së Kosovës, me theks të veçantë në pozita të larta drejtuese dhe vendimmarrëse. Gjithashtu synoi të vlerësonte zbatimin e nenit 6 (Masat e veçanta) të Ligjit për Barazi Gjinore nga institucionet e Republikës së Kosovës, në kontekst të detyrimeve për ndërmarrjen e masave të veçanta për adresimin e pabarazisë mes burrave dhe grave.

Të dhënat e mbledhura tregojnë se pozitat e larta drejtuese dominoheshin dukshëm nga burrat me 77.1%, ndërsa gratë përfaqësoheshin me vetëm 22.9%. Në dy nivelet e tjera, gratë përbënin rreth 31%, ndërsa burrat rreth 69%, çka dëshmonte për një administratë shtetërore të dominuar nga gjinia mashkullore, veçanërisht në nivelet e larta vendimmarrëse. Analiza e të dhënave tregonte po ashtu se gratë nga radhët e komuniteteve etnike ishin edhe më pak të përfaqësuara krahasuar me burrat. Në këtë kontekst, institucioneve në të gjitha nivelet u takonte detyrimi të siguronin që parimet e Ligjit për Barazi Gjinore të transpozoheshin dhe të reflektoheshin në politikat publike, në iniciativat ligjore dhe në aktet nënligjore, me qëllim të adresimit të pabarazive gjinore.

Ex officio nr. 224/2023 lidhur me Ndryshimin e Rregullores (MFPT) nr. 02/2023 për Shtesën për Kushte të Tregut të Punës.⁷

Avokati i Popullit konstatoi se disa dispozita të Rregullores MFPT nr. 02/2023, përkatësisht neni 4, paragrafi 4.3, dhe neni 7, paragrafi 2, pikat 2.1 dhe 2.2, krijojnë trajtim të pabarabartë për punonjësit e shërbimit civil që kanë përfunduar studimet me vetëfinancim, në vend ose jashtë vendit, pa mbështetje nga Qeveria. Futja e kriterëve që lidhen me profesionet e studimeve të financuara nga Qeveria nuk buron nga ndonjë dispozitë ligjore dhe tejkalon kompetencat e një akti nënligjor, duke e vendosur këtë kategori punonjësisht në një pozitë më pak të favorshme. Ky trajtim vlerësohet si diskriminim i drejtpërdrejtë dhe i shumëfishtë, në kundërshtim me Kushtetutën, me Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe me legjislacionin përkatës për pagat, zyrtarët publikë dhe arsimin e lartë, si dhe me standardet e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Bazuar në këto gjetje, Avokati i Popullit rekomandon që MFPT-ja të bëjë ndryshimet e nevojshme në Rregulloren nr. 02/2023, me qëllim që dispozitat e saj të harmonizohen plotësisht me Kushtetutën, me legjislacionin në fuqi dhe me parimet e trajtimit të barabartë dhe të mosdiskriminimit. Ndryshimi i këtyre dispozitave është i domosdoshëm për të siguruar që të gjithë punonjësit e shërbimit civil të trajtohen në mënyrë të drejtë dhe të barabartë, pavarësisht prejardhjes së financimit të studimeve apo institucionit ku i kanë përfunduar ato.

Raport i Avokatit të Popullit, Ex-Officio nr. 436/2023 lidhur me respektimin e të drejtave të njeriut gjatë zhvillimit të procesit të njohjes dhe verifikimit të statusit të

⁶ <https://oik-rks.org/2024/12/16/raport-i-avokatit-te-popullit-ex-officio-535-2019-ne-lidhje-me-zbatimin-e-masave-te-vecanta-te-parapara-me-nenin-6-masat-e-vecanta-te-ligjit-nr-05-l-020-per-barazi-gjinore-nga-ana-e-organeve-legji/>

⁷ <https://oik-rks.org/2024/09/12/raport-i-avokatit-te-popullit-ex-officio-nr-224-2023-lidhur-me-ndryshimin-e-rregullores-mfpt-nr-02-2023-per-shtesen-per-kushte-te-tregut-te-punes/>

viktimës së dhunës seksuale gjatë luftës çlirimtare në Kosovë dhe pengesat e realizimit të beneficioneve të përcaktuara me ligj⁸

Në raportin e publikuar më 24 gusht 2024, Avokati i Popullit ngre shqetësime të rëndësishme lidhur me procesin e verifikimit dhe njohjes së statusit të viktimës së dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë. Gjetjet zbulojnë se Rregullorja nr. 22/2015 ka zbrazëtira ligjore që shkaktojnë pasiguri dhe jokonsistencë në procedurat administrative, për shkak të mungesës së afateve të qarta për vendimmarrje dhe përdorimit të termave juridikë të paqartë, si: “ankesë” dhe “kërkesë për rishqyrtim”. Për më tepër, trajtimi i viktimave gjatë intervistimit nuk garanton gjithmonë kushte të denja, konfidencialitet dhe mbrojtje nga ritraumatizimi, çka tregon për mungesa infrastrukturore dhe organizative që pengojnë qasjen e barabartë në drejtësi dhe mbështetje.

Për të adresuar këto mangësi, Avokati i Popullit nxori një sërë rekomandimesh për institucionet përgjegjëse, duke përfshirë Qeverinë, Ministrinë e Punëve të Brendshme, Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, si dhe Këshillin Gjyqësor të Kosovës. Rekomandimet përfshijnë përmirësimin e rregulloreve dhe procedurave ligjore, përcaktimin e qartë të afateve kohore, sigurimin e kushteve të përshtatshme për intervistim duke respektuar dinjitetin e viktimave, pajisjen e tyre me kohë me kartela identifikuese, si dhe sigurimin e mbështetjes psiko-sociale të nevojshme për riintegrim. Po ashtu, raporti mirëpret zhvillimet pozitive në ndjekjen penale të krimeve të dhunës seksuale, duke përfshirë aktakuzat e para dhe vendimin e Gjykatës Supreme për një rast konkret të dënimit të autorit të dhunës seksuale gjatë luftës.

Raportet me rekomandime lidhur me rastet individuale

A. nr. 540/2023 lidhur me diskriminimin mbi baza gjinore me rastin e përzgjedhjes së zëvendës drejtorit të Radiotelevizionit të Kosovës⁹

Raporti bazohej në një ankesë individuale dhe pati për qëllim të tërhiqte vëmendjen e Radiotelevizionit të Kosovës (RTK) lidhur me procedurën e përzgjedhjes së zëvendës drejtorit të përgjithshëm, si dhe me zbatimin e Ligjit nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore, në kontekst të përfaqësimit të barabartë gjinor në konkursin e datës 22 nëntor 2022. Avokati i Popullit vlerësoi se procesi i rregullt dhe i drejtë i zhvilluar nga RTK-ja në këtë rast ishte vënë në pikëpyetje, ngase çështja iu kthye për rishqyrtim të njëjtit Komision Përzgjedhës. Ky komision, sipas gjetjeve të Komisionit të Ankesave, bëri lëshime që dëmtojnë integritetin e procesit rekrutues. Gjithashtu, u konstatua se mungesa e qartësisë dhe transparencës së rregulloreve të brendshme të punësimit krijoi pasoja negative për të drejtat e kandidatëve dhe punonjësve. Për këtë arsye, Avokati i Popullit theksoi se respektimi i procedurave të qarta rekrutuese ishte një parakusht thelbësor për të garantuar një proces të drejtë, të paanshëm dhe të strukturuar.

Në vijim të analizës, Avokati i Popullit vlerësoi se në këtë rast u shkel parimi i barazisë gjinore, duke qenë se nga katër kandidatët që iu nënshtruan procedurave të rekrutimit, ankuesja ishte e vetmja kandidate femër. Ky fakt nxori në pah domosdoshmërinë e zbatimit

⁸ <https://oik-rks.org/2024/10/31/raport-i-avokatit-te-popullit-ex-officio-nr-436-2023-lidhur-me-respektimin-e-te-drejtave-te-njeriut-gjate-zhvillimit-te-procesit-te-njohjes-dhe-verifikimit-te-statusit-te-viktimes-se-dhunes-seksuale/>

⁹ <https://oik-rks.org/2025/02/14/raport-i-avokatit-te-popullit-a-nr-540-2023-lidhur-me-diskriminimin-mbi-baza-gjinore-me-rastin-e-perzgjedhjes-se-zevendesdrejtorit-te-radiotelevizionit-te-kosoves/>

më të përgjegjshëm të dispozitave ligjore që garantojnë përfaqësim të barabartë gjinor, me qëllim shmangien e trajtimeve diskriminuese dhe promovimin e barazisë efektive në pozita vendimmarrëse.

R. nr. 522/2024 lidhur me Vendimin Nr. 43/III/2024 të Ministrisë së Shëndetësisë, të datës 22 mars 2024, përkitazi me mbulimin e trajtimit mjekësor të personave me status të invalidit të luftës së UÇK-së¹⁰

Ky raport u hartua duke u bazuar në një ankesë individuale dhe pati për qëllim të tërhiqte vëmendjen e Ministrisë së Shëndetësisë lidhur me zbatimin e Vendimit Nr.01/194, të datës 20 mars 2024, për mbulimin e trajtimit mjekësor të personave me status të invalidit të luftës, të nxjerrë nga Qeveria e Republikës së Kosovës, në përputhje me nenin 6 të Ligjit nr.04/L-054 për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), Viktimave Civile dhe Familjeve të tyre. Avokati i Popullit shqyrtoi përmbajtjen dhe qëllimin e vendimit dhe vlerësoi ndikimet që ky vendim pati mbi të drejtat e kategorive të ndryshme të personave me status të invalidit.

Avokati i Popullit konstatoi se Vendimi Nr.43/III/2024, i datës 22 mars 2024, i nxjerrë nga Ministria e Shëndetësisë, përbënte një qasje diskriminuese, pasi përcaktonte përfitimet vetëm për personat me status të invalidit të luftës së UÇK-së, duke përjashtuar kategorinë e personave me status të invalidit civil të luftës. Kjo ishte në kundërshtim me dispozitat e nenit 6, paragrafi 1.7, të Ligjit Nr.04/L-054, të cilat garantojnë të njëjtat beneficione për të dyja kategoritë. Në këtë kontekst, Avokati i Popullit vlerësoi se veprimi krijoi trajtim të pabarabartë dhe shkeli parimet e barazisë dhe të mosdiskriminimit.

Raport i Avokatit të Popullit A.nr. 526/2023, R.nr. 812/2024 dhe R.nr. 867/2024, në lidhje me ndërmarrjen e veprimeve përkatëse në drejtim të zgjerimit të Listës së Barnave Esenciale, duke përfshirë barna të reja që mund të përmirësojnë ndjeshëm shëndetin dhe cilësinë e jetës së qytetarëve që vuajnë nga sëmundje të rënda¹¹

Avokati i Popullit hetoi edhe tri ankesa individuale me pretendim për cenim të të drejtave për shkak të mospërfshirjes së disa barnave, të cilat, sipas ankuesve, janë esenciale për shëndetin dhe jetën e tyre. Pas hetimit të këtyre rasteve, Avokati i Popullit publikoi Raport me rekomandime në lidhje me ndërmarrjen e veprimeve përkatëse në drejtim të zgjerimit të Listës së Barnave Esenciale, duke përfshirë barna të reja që mund të përmirësojnë ndjeshëm shëndetin dhe cilësinë e jetës së qytetarëve që vuajnë nga sëmundje të rënda.

Opinione

Opinion R.nr. 50/2024 në lidhje me detyrimet e organeve shtetërore për të vepruar në përputhje me parimet e Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹²

Avokati i Popullit vlerësoi se vendimi për ndërprerjen e marrëdhënies së punës të ankuses, kryesuese e Bordit të Komisionit të Pavarur për Miniera e Minerale (KPM), është marrë

¹⁰ <https://oik-rks.org/2024/12/05/raport-i-avokatit-te-popullit-r-nr-522-2024-ne-lidhje-me-vendimin-nr-43-iii-2024-te-ministrise-se-shendetesise-te-dates-22-mars-2024-perkitazi-me-mbulimin-e-trajtimit-mjekesor-te-personave-me-stat/>

¹¹ <https://oik-rks.org/2024/12/20/raport-i-avokatit-te-popullit-a-nr-526-2023-r-nr-812-2024-dhe-r-nr-867-2024-ne-lidhje-me-ndermarrjen-e-veprimeve-perkatese-ne-drejtim-te-zgjerimit-te-listes-se-barnave-esenciale-duke-perfshire-ba/>

¹² <https://oik-rks.org/2024/12/05/avokati-i-popullit-opinion-r-nr-50-2024-ne-lidhje-me-detyrimet-e-organeve-shtetere-per-te-vepruar-ne-perputhje-me-parimet-e-ligjit-per-mbrojtje-nga-diskriminimi/>

nga një organ jokompetent dhe në mënyrë të paligjshme, në kundërshtim me Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative (nenet 4 dhe 52). Për më tepër, nga shqyrtimi i praktikave të mëparshme të KPMM-së, rezulton se një rast i ngjashëm me një anëtar mashkull të Bordit, i cili arriti moshën e pensionimit gjatë mandatit, nuk rezultoi me ndërprerje të punës, duke treguar një trajtim të pabarabartë dhe një diskriminim të shumëfishtë kundër ankueses, sipas përcaktimit të Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi (neni 4, paragrafi 1, nënparagrafi 1.10). Kjo qasje cenon parimet e ligjshmërisë dhe barazisë, duke lënë ankuesen në një pozitë më pak të favorshme dhe duke shkelur të drejtën e saj për trajtim të barabartë.

Avokati i Popullit rekomandoi që KPMM-ja të rishikojë praktikën e saj, në mënyrë që vendimet administrative të merren vetëm nga organet kompetente dhe në përputhje të plotë me parimet e Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi, duke garantuar trajtim të barabartë për të gjithë anëtarët e Bordit, pavarësisht gjinisë apo moshës. Gjithashtu, institucioni theksoi nevojën për zbatim të rregullt të legjislacionit në fuqi, për të shmangur çdo formë diskriminimi, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, dhe riafirmon angazhimin e tij për të mbrojtur të drejtat e njeriut dhe parimin e trajtimit të barabartë në institucionet publike.

Opinion ligjor i Avokatit të Popullit në cilësinë e Mikut të Gjykatës (Amicus Curiae) për Gjykatën Themelore të Prishtinës, R. nr. 175/2024, lidhur me diskriminimin dhe shkeljen e dinjitetit të pjesëtarëve të komunitetit LGBTIQ+, si dhe padinë C. nr. 2993/2024 të paraqitur më 1 mars 2024 në Gjykatën Themelore në Prishtinë¹³

Avokati i Popullit pranoi një ankesë nga disa organizata të shoqërisë civile kundër Kuvendit të Republikës së Kosovës, lidhur me diskriminimin dhe shkeljen e dinjitetit të personave LGBTIQ+ gjatë seancës plenare të mbajtur më 16 mars 2022. Në të njëjtën ditë, organizatat paraqitën edhe padinë (C.nr. 2993/2024) në Gjykatën Themelore të Prishtinës. Avokati i Popullit, pas analizimit të rrethanave, vendosi t'ia paraqiste kësaj gjykate mendimin e tij në cilësinë e mikut të gjykatës (*amicus curiae*).

Avokati i Popullit konstatoi se deklaratat e bërë nga deputetët gjatë debatit mbi nenin 1138, paragrafi 2, të Projektkodit Civil (nr. 08/L-124) ishin diskriminuese dhe shkelën dinjitetin e personave LGBTIQ+, duke krijuar një mjedis poshtërues dhe fyes. Ai vuri në dukje se liria e fjalës dhe e shprehjes nuk mund të përdoret si justifikim për gjuhën e urrejtjes, për promovimin e paragjytimeve apo krijimin e një mjedisi armiqësor për një grup të caktuar njerëzish. Avokati gjithashtu theksoi përgjegjësinë e veçantë të përfaqësuesve të popullit dhe të organeve publike për të shmangur mbështetjen e stereotipave dhe paragjytimeve, si dhe për të promovuar tolerancën dhe respektimin e të drejtave të të gjithëve, pa diskriminim. Bazuar në këtë vlerësim dhe në praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNj), deklaratat e deputetëve u vlerësuan si gjuhë urrejtjeje ndaj komunitetit LGBTIQ+ dhe si veprim që krijoi një ambient diskriminues në Kuvend.

¹³ <https://oik-rks.org/2024/12/05/opinion-ligjor-i-avokatit-te-popullit-ne-cilesine-e-mikut-te-gjykares-amicus-curiae-per-gjykatën-themelore-te-prishtinës-r-nr-175-2024-lidhur-me-diskriminimin-dhe-shkeljen-e-dinjitetit-te-pjeset/>

Opinion R. nr. 151/2024 në lidhje me detyrimet e Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” për të vepruar në përputhje me parimet e Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹⁴

Ky opinion u hartua nga Avokati i Popullit me qëllim që të ofronte qëndrimin lidhur me detyrimet e Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” (UP), që gjatë ushtrimit të detyrave dhe përgjegjësi të vepronte në përputhje me parimet e Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi dhe me legjislacionin përkatës në fuqi. Opinioni u bazua në një ankesë të parashtruar kundër UP-së, lidhur me pretendimin për cenim të së drejtës së punës dhe ushtrimit të profesionit, si dhe për trajtim të pabarabartë dhe diskriminim në procesin e themelimit të marrëdhënies së punës. Avokati i Popullit vlerësoi se, duke marrë parasysh faktin se ankuesi nuk ishte i punësuar në UP dhe nuk ishte student, kërkesa e rektorit drejtuar Këshillit të Etikës përbënte shkelje të procedurave të përcaktuara me Rregulloren nr. 886. Ky vlerësim u mbështet në dispozitat e Kodit të Etikës të UP-së, i cili në nenin 3 përcaktonte fushëveprimin dhe zbatohet vetëm për stafin akademik të punësuar, duke përjashtuar kandidatët në procedurat e përzgjedhjes së stafit akademik.

Avokati i Popullit vlerësoi gjithashtu se as Rregullorja nr. 886 nuk përmbante dispozita që rregullonin çështjen e kredibilitetit apo integritetit të kandidatëve të papunësuar në UP, dhe se një vlerësim i tillë kryhej përmes paraqitjes së dëshmisë nga gjykata kompetente se kandidati nuk ishte nën hetime dhe nuk ishte i dënuar, sipas kushteve të Konkursit nr. 1/331, të datës 31 maj 2023. Veprimet e rektorit, vendimi i Këshillit të Etikës dhe vendimi përfundimtar i Senatit e vendosën ankuesin në një pozitë të pabarabartë dhe përbënin diskriminim sipas nenit 1 të Ligjit nr. 05/L-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi, duke cenuar të drejtën për trajtim të barabartë dhe duke shkelur parimin e mosdiskriminimit mbi bazë të statusit, origjinës ose bazave të tjera të mbrojtura ligjërisht.

Opinion A. nr. 295/2022 përkitazi me pretendimin për cenim të lirisë së asociimit dhe ushtrimit të aktivitetit sindikal, si dhe diskriminim për shkak të angazhimit sindikal¹⁵

Ky opinion pasqyroi qëndrimet e Avokatit të Popullit lidhur me cenimin e lirisë së asociimit dhe të organizimit të aktivitetit sindikal të të punësuarve të Limak Kosovo International Airport J.S.C. “Adem Jashari” (ANP). Avokati i Popullit vlerësoi se institucionet përgjegjëse duhej ta jepnin vëmendjen e duhur për mbikëqyrjen e respektimit të plotë të dispozitave të Ligjit të Punës dhe të Ligjit për Organizim Sindikal, me qëllim të mbrojtjes së të drejtave që rridhnin nga marrëdhënia e punës dhe organizimi i aktivitetit sindikal të punëtorëve të ANP-së.

Në opinion theksohej se autoritetet duhej të ndërmerrnin masat e nevojshme për të garantuar ushtrimin e aktivitetit sindikal nga kryetari i Shoqatës Sindikale të ANP-së dhe nga punëtorët e aeroportit, pa ndonjë ndikim në trajtimin e pabarabartë në raport me punëtorët joanëtarë të sindikatës. Po ashtu, Avokati i Popullit vlerësoi si të nevojshme gjetjen e modaliteteve të komunikimit dhe lejes për ushtrimin e aktivitetit sindikal në hapësirat e rezervuara për Sindikatën nga ANP-ja.

¹⁴ <https://oik-rks.org/2024/12/16/opinion-i-avokatit-te-popullit-r-nr-151-2024-ne-lidhje-me-detyrimet-e-universitetit-te-prishtines-hasan-prishtina-per-te-vepruar-ne-perputhje-me-parimet-e-ligjit-per-mbrojtjen-nga-diskriminimi/>

¹⁵ <https://oik-rks.org/2024/05/14/opinion-i-avokatit-te-popullit-a-nr-2952022-perkitazi-me-pretendimin-per-cenim-te-lirise-se-asociimit-dhe-ushtrimit-te-aktivitetit-sindikal-si-dhe-diskriminim-per-shkak-te-angazhimit-sindikal/>

Kërkesat kushtetuese

Kërkesa në Gjykatën Kushtetuese për vlerësimin e Ligjit nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme

Avokati i Popullit vlerësoi se neni 28 i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, i cili përcakton kuotën gjinore prej së paku 30%, nuk siguron barazi reale për gratë në listat zgjedhore. Miratimi i këtij ligji në procedurë të përshpejtuar kufizoi mundësinë e pjesëmarrjes së plotë të Avokatit të Popullit dhe të subjekteve të interesuara në procesin e diskutimit dhe ofrimit të komenteve mbi çështjet e barazisë gjinore. Edhe pse kuota 30% në dukje duket e barabartë, në praktikë subjektet politike e kanë përmbushur këtë minimum duke dërguar lista me 30% gra dhe 70% burra, shpesh me gratë të pozicionuara më poshtë në listë, duke ruajtur një situatë të vazhdueshme të nënpërfaqësimit të grave. Avokati i Popullit theksoi se kjo gjendje përbën pabarazi dhe diskriminim të tërthortë dhe kërkoi nga Gjykata Kushtetuese që të vlerësonte pajtueshmërinë e nenit 28 me nenet 7, 24 dhe 45 të Kushtetutës, në lidhje me vlerat kushtetuese, barazinë para ligjit dhe barazinë gjinore.

Më 27 dhjetor 2024, Gjykata Kushtetuese, me Aktgjykimin KO 15/24, vendosi se neni 28 është në përputhje me nenin 45 të Kushtetutës. Megjithatë, Gjykata nuk u deklarua mbi pajtueshmërinë e nenit 28 me nenin 7 dhe nenin 24, duke lënë çështjen e barazisë gjinore të paplotë. Avokati i Popullit nënvizon se kuota prej 30% nuk e promovon pjesëmarrjen e barabartë të grave dhe burrave në praktikë dhe riafirmon kërkesën e tij për një mekanizëm ligjor që garanton përfaqësim të barabartë në listat zgjedhore. Institucioni do të vazhdojë të angazhohet aktivisht për barazinë gjinore, duke kërkuar standarde ligjore dhe procedurale që shmangin nënpërfaqësimin e grave dhe sigurojnë trajtim të drejtë për të gjithë kandidatët.

Kërkesë për vlerësimin e përputhshmërisë me Kushtetutën të nenit 8A, paragrafi 2, nënparagrafi 2.4, të Ligjit nr. 08/L-248 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti

Avokati i Popullit paraqiti këtë kërkesë kushtetuese lidhur me Ligjin nr. 08/L-248 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti. Kërkesa ka për qëllim që Gjykata Kushtetuese të vlerësojë kushtetutshmërinë e nenit 4 të Ligjit të kontestuar, duke marrë parasysh parimet e barazisë para ligjit dhe ndalimin e diskriminimit, si dhe të konstatojë nëse ky nen përputhet me dispozitat kushtetuese dhe standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Avokati i Popullit kërkoi të konstatohet se dispozitat e Ligjit nr. 08/L-248 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 04/L-131 janë në kundërshtim me nenet 23 (Dinjiteti i Njeriut) dhe 24 (Barazia para Ligjit) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe me nenet 14 dhe 1 të Protokollit nr. 12 të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), për shkak se një kriter prej 15 vitesh stazh pune si kusht për pension kontributpagues – për periudhën 1989-1999, përjashton në mënyrë të padrejtë punëtorët që, për shkak të largimeve nga puna gjatë viteve të konfliktit, nuk kishin mundësi t'i plotësonin ato vite kontribute.

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, pasi shqyrtoi çështjen, vendosi njëzëri se neni 4 i ligjit të kontestuar, i cili shton nenin 8A në Ligjin bazik për Skemat Pensionale nuk është në kundërshtim me nenin 24 të Kushtetutës (Barazia para Ligjit) dhe dispozitat e KEDNJ-së për ndalimin e diskriminimit. Gjykata vlerësoi se ndryshimi ligjor adresoi në mënyrë adekuate situatën e grupeve që janë larguar nga puna për arsye diskriminuese gjatë viteve 1989–1999, duke krijuar një skemë të re “pensioni parcial kontributpagues i moshës”,

që mundëson përfshirjen e atyre personave edhe në raste kur nuk i plotësojnë 15 vjet stazh pune, për sa kohë argumentohet largimi nga puna gjatë kësaj periudhe.

Aktivite promovuese lidhur me barazinë

Avokati i Popullit realizoi dhe është përfshirë në një varg angazhimesh që kanë të bëjnë me garantimin e barazisë para ligjit dhe mbrojtjen nga diskriminimi. Një pjesë e madhe e këtyre aktiviteteve janë kryer në bashkëpunim me institucionet vendore, me organizata ndërkombëtare dhe me organizata të shoqërisë civile. Kjo përfshin Projektin për “Përmirësimin e të Drejtave Gjuhësore”, aktivitetet e përbashkëta me Zyrën e Komisionarit për Gjuhët në lidhje me nivelin e zbatimit të Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve Zyrtare, takimet e Grupit Punues për Barazi Gjinore, Webinarin “Organet e Barazisë që promovojnë të drejtat e Familjeve Ylber,” pjesëmarrja në punëtori dhe veprimtari të tjera për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, barrën administrative të bashkësive joshumicë etj. Po ashtu, gjatë periudhës raportuese janë realizuar vizita studimore jashtë vendit, paraqitje në medie për tema që kanë të bëjnë me barazinë para ligjit, si dhe veprimtari të tjera që promovojnë barazinë para ligjit dhe mosdiskriminimin.

V. TË GJETURAT E AVOKATIT TË POPULLIT NË ROLIN MBIKEQYRËS NË ZBATIMIN E LIGJIT PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Grumbullimi i të dhënave lidhur me Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi

Në Raportin e Avokatit të Popullit lidhur me zbatimin e LMD-së, dërguar Kuvendit më 11 dhjetor 2024, u konstatua se përgjithësisht institucionet në Republikën e Kosovës nuk mbajnë të dhëna lidhur me ankesat dhe rastet e diskriminimit.

Për të hartuar këtë Raport, Avokati i Popullit gjatë periudhës qershor-gusht 2025 kërkoi informacione, si cilësore dhe sasiore, lidhur me zbatimin e LMD-së nga 93 institucione, organe dhe autoritete. Kërkesat u dërguan përmes shkresave të veçanta, të cilat përmbanin sqarime të nevojshme dhe pyetje specifike, që i përshtateshin natyrës së institucionit apo organizatës që i drejtohej.

Kërkesa për informacione u janë dërguar institucioneve në vijim:

Kuvendit të Kosovës, Zyrës së Presidentes, Zyrës së Kryeministrit, ministrive, Këshillit Gjyqësor, Këshillit Prokurorial, Gjykatës Kushtetuese, Policisë së Kosovës, Inspektoratit të Punës, Inspektoratit Shëndetësor, Inspektoratit Qendror të Arsimit, Komisionarit Parlamentar të FSK-së, komunave.

Institucioneve dhe agjencive të pavarura, si:

Bankës Qendrore të Kosovës, Zyrës Kombëtare të Auditimit, Komisionit të Pavarur të Mediave, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Doganës së Kosovës, Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturor, Radiotelevizionit të Kosovës, Autoritetit të Konkurrencës, Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas, Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, Agjencisë Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës, Agjencisë Kosovare të Privatizimit, Agjencisë për Informim dhe Privatësi, Agjencisë së Statistikave të Kosovës, Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit, Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik, Trustit të Kursimeve Pensionale. Gjithashtu, kërkesa për informacione u është dërguar edhe institucioneve publike të arsimit të lartë.

Përgjigjet e pranuar nga Avokati i Popullit

Nga gjithsej 93 institucione dhe organe të kontaktuara, 50 kanë kthyer përgjigje, ndërsa 43 nuk janë përgjigjur. Më poshtë paraqiten në mënyrë të përmbledhur përgjigjet e pranuar, sipas pyetjeve specifike të parashtruara nga Institucioni i Avokatit të Popullit.

Kuvendi i Republikës së Kosovës

Kuvendi ka kthyer përgjigje dhe ka bërë të ditur se, ndonëse nuk ka një mekanizëm të posaçëm për raportimin e rasteve të diskriminimit, ankesat mund të paraqiten përmes Drejtorisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore. Sipas të dhënave të ofruara, gjatë vitit të raportimit nuk është paraqitur asnjë rast i diskriminimit, as në nivel të brendshëm dhe as përmes procedurave gjyqësore apo administrative. Kuvendi mban evidencë për ankesat nëse ato paraqiten. Megjithatë, faja zyrtare aktualisht nuk përmban informacione për mënyrën e paraqitjes së ankesës te Avokati i Popullit.

Zyra e Presidentit

Zyra e Presidentit nuk ka kthyer përgjigje në pyetjet e paraqitura. Si rrjedhojë, nuk ka informacione lidhur me ekzistimin e mekanizmave, rastet e raportuara apo funksionalizimin e faqeve zyrtare në raport me procedurat e ankesave për diskriminim.

Zyra e Kryeministrit dhe njësitë brenda saj

Zyra e Kryeministrit ka konfirmuar ekzistencën e mekanizmave për trajtimin e çështjeve të diskriminimit, por nuk ka ofruar informacion të detajuar për rastet. Ndërkohë, Zyra për Qeverisje të Mirë ka një mekanizëm të konsoliduar dhe ka raportuar trajtimin e 18 rasteve gjatë vitit 2024. Po ashtu, Zyra e Komisionarit për Gjuhët ka mekanizma funksionalë dhe ka trajtuar 16 ankesa gjatë vitit 2024, duke lëshuar edhe rekomandime *ex officio*. Asnjëra nga këto zyra nuk ofron informacion të mjaftueshëm në ueb-faqe, sidomos për paraqitjen e ankesave te Avokati i Popullit.

Ministritë

Nga 15 ministri, 11 kanë kthyer përgjigje¹⁶, ndërsa 4 nuk kanë kthyer përgjigje¹⁷. Shumica e ministrive që janë përgjigjur kanë konfirmuar se nuk kanë pasur raste të raportuara për diskriminim, por disa prej tyre kanë theksuar se ekzistojnë mekanizma të përgjithshëm të ankesave ose komisione të brendshme për trajtimin e tyre, si në rastin e MASHTI-t dhe MPB-së. Disa ministri, si MINT-i dhe MZHR-ja, edhe pse nuk kanë mekanizma të posaçëm ose raste të dokumentuara, kanë shprehur gatishmëri të trajtojnë çështjet e ngritura si rekomandime të Avokatit të Popullit. Ndërkohë, disa ministri, si MSH-ja, ka raportuar për 40 kërkesa për qasje në dokumente publike dhe 172 ankesa për diskriminim në konkursin për shkollim specialistik. Nga ana tjetër, 4 ministri (MKRS, MAPL, ME dhe MPJD) nuk kanë kthyer fare përgjigje, duke lënë bosh hapësirën për vlerësim të praktikave të tyre në raport me trajtimin e ankesave për diskriminim dhe transparencën institucionale.

¹⁶ Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI), Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT), Ministria e Zhvillimit Rural (MZHR), Ministria e Punëve të Brendshme (MPB), Ministria e Mbrojtjes (MM), Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR), Ministria për Komunitete dhe Kthim (MKK), Ministria e Drejtësisë (MD), Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT), Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), Ministria e Shëndetësisë (MSH).

¹⁷ Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS), Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), Ministria e Ekonomisë (ME), Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës (MPJD).

Komunat

Nga 38 komuna, vetëm 15 kanë kthyer përgjigje¹⁸ në kërkesën e Avokatit të Popullit, ndërsa 23 nuk kanë kthyer përgjigje¹⁹. Nga komunat që kanë kthyer përgjigje rezultojnë se

komunat: Obiliq, Drenas, Graçanicë, Gjiilan, Ferizaj, Mamushë, Podujevë, Lipjan, Shtime, Han i Elezit, Rahovec, Vushtrri, Istog raportojnë se kanë mekanizma të caktuar për trajtimin e rasteve të diskriminimit, kryesisht përmes njësive të të drejtave të njeriut ose barazisë gjinore.

Pothuajse në të gjitha komunat që janë përgjigjur nuk është raportuar asnjë rast i diskriminimit për vitin 2024.

Vetëm Komuna e Shtimes ka raportuar një rast të iniciuar në gjykatë, ndërsa Istogu ka raportuar një rast të identifikuar përmes platformave të komuniteteve.

Evidentimi i ankesave është i pranishëm në disa komuna, por mungon ose është i pjesshëm në të tjerat.

Faqet zyrtare të komunave shpesh nuk përmbajnë informacion të dedikuar lidhur me të drejtën për paraqitjen e ankesave te Avokati i Popullit, ndonëse disa komuna kanë marrë këtë si rekomandim dhe janë në proces të përmirësimit.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës

KGJK-ja ka kthyer përgjigje ndaj kërkesës, por nuk ka ofruar informacione lidhur me ekzistimin e mekanizmave apo procedurave të brendshme për raportimin e rasteve të diskriminimit, qoftë nga brenda institucionit, qoftë nga palë të treta. Megjithatë, ka ofruar të dhëna mbi tri raste gjyqësore të lidhura me diskriminimin, të cilat janë trajtuar në Gjykatën Themelore në Prizren dhe në degën e saj në Suharekë, dhe që kanë përfunduar me aktgjykime në shkallë të parë.²⁰

Këshilli Prokurorial i Kosovës

KPK-ja ka kthyer përgjigje, por nuk ka dhënë informacion nëse disponon mekanizma apo procedura të brendshme për raportimin e rasteve të diskriminimit, qoftë brenda institucionit apo nga palë të treta. Po ashtu, për pyetjet lidhur me numrin e kallëzimeve penale dhe procedimeve mbi bazën e nenit 190 të Kodit Penal, KPK-ja nuk ka ofruar asnjë të dhënë. Nga ana tjetër, institucioni ka dhënë informacione të detajuara për rastet e bazuara në nenin 141 të Kodit Penal (Nxitja e përçarjes dhe mosdurimit) për vitet 2022, 2023 dhe 2024. Këto të dhëna përfshijnë numrin e rasteve të pranuar, të zgjidhura dhe të pazgjidhura, mënyrat e zgjidhjes dhe vendimet gjyqësore. Në secilin vit rezultojnë të ketë pasur aktgjykime fajësuese, kallëzime të hedhura, aktakuza pas hetimeve dhe pushim hetimesh, çka tregon se buletinet statistikore të këtij neni përpunohen dhe publikohen rregullisht.

Policia e Kosovës

¹⁸ Komuna e Obiliqit, Komuna e Drenasit, Komuna e Graçanicës, Komuna e Gjiilanit, Komuna e Mitrovicës, Komuna e Ferizajt, Komuna e Mamushës, Komuna e Junikut, Komuna e Podujevës, Komuna e Lipjanit, Komuna e Shtimes, Komuna e Hanit të Elezit, Komuna e Vushtrrisë, Komuna e Rahovecit, Komuna e Istogut.

¹⁹ Komuna e Kaçanikut, Komuna e Deçanit, Komuna e Fushë Kosovës, Komuna e Gjakovës, Komuna e Kamenicës, Komuna e Klinës, Komuna e Leposaviqit, Komuna e Malishevës, Komuna e Mitrovicës së Veriut, Komuna e Pejës, Komuna e Prishtinës, Komuna e Prizrenit, Komuna e Skenderajt, Komuna e Suharekës, Komuna e Vitisë, Komuna e Zubin Potokut, Komuna e Zveçanit, Komuna e Novobërdës, Komuna e Ranillugut, Komuna e Shtërpçës, Komuna e Klllokotit, Komuna e Parteshit, Komuna e Dragashi.

²⁰ 13 qershor 2024 (C.nr. 912/2023), 5 dhjetor 2023 (C.nr. 1722/20236), dhe 25 qershor 2024 (C.nr. 487/22).

Policia e Kosovës ka një strukturë të organizuar për trajtimin e çështjeve të të drejtave të njeriut dhe mbrojtjes nga diskriminimi, përmes Zyrës për të Drejtat e Njeriut dhe Diversitetit dhe një grupi punues për krijimin e Zyrës së Komisionarit për të Drejtat e Njeriut. Megjithatë nuk ka një mekanizëm formal për raportimin e rasteve të diskriminimit të publikuar, strukturat përkatëse trajtojnë kërkesat, raportet ex officio dhe rekomandimet e Avokatit të Popullit. Policia bashkëpunon gjithashtu me Zyrën për Qeverisje të Mirë dhe angazhon zyrtarë në grupe punuese për të ofruar kontribut profesional në trajtimin e çështjeve që lidhen me diskriminimin.

Për sa u përket rasteve konkrete, gjatë vitit 2024 janë pranuar dy raste të dyshuara për veprime diskriminuese, nga të cilat një është vërtetuar dhe ka përfunduar me masë disiplinore (ndalesë page prej 30% për dy muaj). Për rastet e ngacmimeve seksuale janë pranuar nëntë lëndë, prej të cilave një është vërtetuar dhe ka rezultuar me ndalesë page prej 30% të pagës për gjashtë muaj. Policia ka trajtuar gjithashtu raste të tjera të lidhura me urrejtjen dhe diskriminimin, duke përfshirë 44 raste për nxitje të përçarjes, 2.547 raste për dhunë në familje dhe 101 raste për ngacmim seksual. Përveç trajtimit të rasteve, Policia ka zhvilluar trajnime të vazhdueshme për personelin dhe ka hartuar udhëzime dhe procedura standarde për trajtimin e krimeve të urrejtjes dhe për sigurimin e qasjes së barabartë për personat me aftësi të kufizuara.

Inspektoratet

Vetëm Inspektorati Policor i Kosovës ka kthyer përgjigje. Ai trajton të gjitha ankesat në mënyrë të unifikuar pa një mekanizëm të veçantë për diskriminimin. Evidentimi i dokumenteve bëhet sipas rregulloreve për administrimin e lëndëve. Ueb-faqja është në proces të ridizajnit për të përfshirë kërkesat ligjore. Inspektoratet e tjera nuk kanë kthyer përgjigje.²¹

Institucionet e pavarura

Gjykata Kushtetuese ka raportuar disa vendime²² ku është konstatuar shkelja e nenit 24 të Kushtetutës për barazinë para ligjit. Të gjitha vendimet janë publike.

Zyra Kombëtare e Auditimit ka mekanizma të etikës dhe mbajtjes së evidencës, por nuk ka regjistruar raste diskriminimi. Ka një regjistër të veçantë për ankesat.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve nuk ka mekanizma të posaçëm, nuk ka raste dhe nuk ka informacion në ueb-faqe.

Banka Qendrore e Kosovës ka struktura të ankesave, por nuk ka raportuar raste dhe faqja e saj nuk përmban informata mbi procedurat e ankesave për diskriminim.

Komisionari Parlamentar për FSK-në nuk ka pasur asnjë rast të raportuar për diskriminim.

Komisioni i Pavarur i Mediave nuk ka kthyer përgjigje.

Agjencitë dhe autoritetet rregullatore

Shumica e agjencive kanë kthyer përgjigje²³, ndërsa tri nga to nuk janë përgjigjur.²⁴ Megjithatë, pavarësisht përgjigjeve, shumica e tyre nuk kanë mekanizma për raportimin e

²¹ Inspektorati i Punës, Inspektorati Shëndetësor, Inspektorati Qendror i Arsimit.

²² KO232/23, KO233/23, KO79/23, KO100/22 dhe KO101/22, KO190/10

rasteve të diskriminimit, nuk kanë pranuar ankesa të tilla dhe nuk ofrojnë informacione të qarta në faqet e tyre zyrtare, sidomos për sa u përket informacioneve lidhur me mundësinë për paraqitje të ankesave tek Avokati i Popullit.

Dogana e Kosovës

Dogana ka mekanizma për pranimin e ankesave përmes platformave digjitale, si: e-portal, aplikacionet mobile dhe linjat konfidenciale. Nuk ka pasur raste të raportuara për diskriminim. Të gjitha ankesat regjistrohen në protokoll zyrtar. Faqja e tyre përmban informacion për procedurat e ankesave tek Avokati i Popullit.

Radiotelevizioni i Kosovës

RTK-ja ka njoftuar se nuk ka mekanizma të veçantë për trajtimin e ankesave për diskriminim, faqja zyrtare nuk përmban informacion për procedurat e ankesave tek Avokati i Popullit dhe se ka një padi për diskriminim.

Universitetet publike dhe akademitë

Universitetet që kanë kthyer përgjigje²⁵ kanë raportuar se nuk kanë mekanizma të veçantë; nuk kanë raste të raportuara të diskriminimit; nuk kanë regjistra të veçantë, por mbajnë protokolle zyrtare; faqet e tyre zyrtare nuk përmbajnë informata, por institucionet janë zotuar të përmirësojnë këtë. Universitetet e tjera nuk kanë dhënë përgjigje.²⁶

VI. TË GJETURAT E AVOKATIT TË POPULLIT LIDHUR ME DISKRIMINIMIN

Avokati i Popullit paraqet të gjeturat nga hetimi i rasteve lidhur me ankesat e pranuar dhe rastet *ex officio*, si dhe të gjeturat lidhur me zbatimin e LMD-së nga ana e institucioneve publike.

Të gjeturat lidhur me rastet e diskriminimit të hetuara nga Avokati i Popullit

Të gjeturat e Avokatit të Popullit tregojnë se diskriminimi në Kosovë vazhdon të jetë i pranishëm dhe i përhapur në fusha të ndryshme të jetës shoqërore.

Diskriminimi mbi bazën e moshës shpesh shfaqet në forma të shumëfishta, veçanërisht ndaj personave të moshuar që përballen me kufizime në shërbimet shëndetësore, kujdesin social dhe mbështetjen e duhur për mirëqenien e tyre. Në fushën e punësimit, mungesa e transparencës në proceset e rekrutimit dhe trajtimi i pabarabartë i aplikuesve janë probleme të vazhdueshme që pengojnë mundësitë e barabarta në punësim. Pabarazia gjinore është gjithashtu e dukshme në pozitat drejtuese, ku burrat dominojnë në mënyrë të theksuar, ndërsa gratë hasin pengesa për të arritur pozita vendimmarrëse. Diskriminimi gjinor vërehet edhe në të drejtat pronësore dhe trashëgimore, ku normat shoqërore dhe mungesa e informacionit i kufizojnë gratë në ushtrimin e këtyre të drejtave. Një tjetër formë diskriminimi që mbetet shqetësuese është ajo etnike, veçanërisht për punësim në sektorin publik, ku komunitet joshumicë vazhdojnë të jenë të nënpërfaqësuar në institucionet publike.

²³ Autoriteti i Konkurrencës, Agjencia e Statistikave të Kosovës, Agjencia për Informim dhe Privatësi, Agjencia Kosovare e Privatizimit, Agjencia Kosovare për Krahaskim dhe Verifikim të Pronës, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, si dhe Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil.

²⁴ Agjencia për Trashëgimi Kulturor dhe Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik, Trusti i Kursimeve Pensionale.

²⁵ Universiteti i Gjakovës “Fehmi Agani”, Universiteti i Shkencave të Aplikuara, Akademia e Kosovës për Siguri Publike.

²⁶ Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina; Universiteti i Pejës “Haxhi Zeka”; Universiteti i Mitrovicës “Isa Boletini”; Universiteti i Gjilanit “Kadri Zeka”; Universiteti i Prizrenit “Ukshin Hoti”.

Përveç vlerësimit të akteve normative dhe nxjerrjes së opinioneve ligjore, Avokati i Popullit ka trajtuar raste të ndryshme dhe ka publikuar raporte me rekomandime lidhur me diskriminimin, të bazuara në ankesa individuale dhe në monitorimin e zbatimit të rekomandimeve dhe opinioneve të tij. Ai ka evidentuar se në Kosovë ekzistojnë praktika dhe dispozita që çojnë në trajtim të pabarabartë dhe diskriminues në fusha të ndryshme të administratës publike, legjislacionit dhe shërbimeve shtetërore.

Në fushën e punësimit dhe të shërbimeve publike, Avokati i Popullit ka konstatuar se disa dispozita ligjore dhe nënligjore favorizojnë grupe të caktuara të punonjësve, duke i vendosur të tjerët në pozita më pak të favorshme dhe duke cenuar parimet e barazisë dhe mosdiskriminimit. Ai ka evidentuar raste të ndërprerjes së paligjshme të marrëdhënies së punës, trajtim të pabarabartë ndaj grave dhe mospërfshirje të personave me status të veçantë, përfshirë punonjësit invalidë dhe personat me aftësi të kufizuara. Avokati i Popullit ka theksuar nevojën për harmonizimin e dispozitave ligjore dhe procedurave administrative me Kushtetutën dhe standardet ndërkombëtare.

Personat me aftësi të kufizuara përballen me pengesa të shumta për qasje në hapësira publike, mundësi punësimi dhe përfitime shëndetësore. Këto përfshijnë nevojën për rivlerësim të statusit të personave paraplegjikë dhe tetraplegjikë, përmirësim të kurrikulave për personat e shurdhër dhe mbulim adekuat të trajtimit mjekësor, duke përfshirë edhe personat me status të invalidit të luftës së UÇK-së.

Në fushën e shëndetësisë janë konstatuar mangësi në sigurimin e barnave esenciale dhe mungesë e Sistemit Informativ Shëndetësor, që kufizon qasjen e qytetarëve në shërbime të nevojshme. Avokati i Popullit ka vlerësuar se liria e besimit dhe praktika fetare nuk respektohen në mënyrë të barabartë, duke evidentuar mungesë të njohjes ligjore për disa bashkësi fetare dhe raste diskriminimi, përfshirë largime nga shkolla për shkak të manifestimit të besimit fetar.

Barazia gjinore vazhdon të sfidohet nga pabarazitë në punësim, përfaqësim në pozita vendimmarrëse dhe në të drejtën pronësore dhe trashëgimi për gratë. Përkatësia etnike mbetet e diskriminuar për shkak të mungesës së përfaqësimit të barabartë në sektorin publik dhe të incidenteve ndëretnike. Personat LGBTIQ+ përballen me shkelje të dinjitetit dhe gjuhë urrejtjeje në diskursin publik, duke kërkuar nga autoritetet masa për mbrojtjen dhe garantimin e të drejtave të tyre.

Avokati i Popullit ka theksuar gjithashtu nevojën për mbrojtjen e grave viktime të dhunës, përfshirë viktimat e dhunës seksuale gjatë luftës, si dhe për parandalimin e çdo forme tjetër të diskriminimit. Në përgjithësi, gjetjet tregojnë se ekzistojnë barriera sistematike dhe praktika diskriminuese në shumë fusha, duke nënvizuar domosdoshmërinë e ndërhyrjeve ligjore dhe administrative për të garantuar barazi, trajtim të drejtë dhe qasje të barabartë për të gjithë qytetarët.

Të gjeturat e Avokatit të Popullit lidhur me zbatimin e LMD-së nga ana e institucioneve publike

Para paraqitjes së gjetjeve specifike dhe rekomandimeve konkrete të Raportit, duhet vënë në pah se, në krahasim me raportin e vitit të kaluar, ky Raport është mbështetur në numër më të madh të dhënash, të cilat janë marrë nga të gjitha hallkat institucionale të Republikës së Kosovës. Megjithatë, mungesa e të dhënave të plota ndërinstitucionale lidhur me rastet e diskriminimit në nivel vendi mbetet sfida kryesore për përcjelljen e zbatimit të LMD-së.

Funksionalizimi i mekanizmave për mbrojtje nga diskriminimi – Për sa i përket themelimit të mekanizmave për mbrojtje nga diskriminimi nga institucionet që kanë kthyer përgjigje në shkresën e Avokatit të Popullit, vërehet se një pjesë e konsiderueshme kanë themeluar mekanizma për raportim të rasteve të diskriminimit. Disa institucione nuk kanë themeluar mekanizma të veçantë për mbrojtjen nga diskriminimi, por ankesat trajtohen përmes komisioneve, procedurave të shërbimit civil, apo përmes zyrtarëve të caktuar. Ndërsa, disa institucione janë në proces të krijimit të mekanizmave për mbrojtje nga diskriminimi.

Raste të raportuara për diskriminim - Raste konkrete të raportuara gjatë vitit 2024 janë të rralla. Policia e Kosovës ka trajtuar dy raste veprimesh diskriminuese dhe nëntë raste ngacmimesh seksuale, disa prej të cilave kanë rezultuar me masa disiplinore. Disa ministri, si Ministria e Shëndetësisë, kanë raportuar ankesa për diskriminim në procedura të caktuara, ndërsa disa komuna (p.sh. Istogu dhe Shtimja) kanë raportuar një ose dy raste konkrete. Gjykatat kanë evidentuar tri raste të trajtuara në Gjykatën Themelore të Prizrenit dhe në degën e saj në Suharekë, të përfunduara me aktgjykime në shkallë të parë. Shumica e institucioneve të tjera nuk kanë raportuar raste për diskriminim.

Evidentimi i rasteve të diskriminimit - Shumë institucione kanë raportuar se nuk mbajnë regjistra të veçantë për rastet/ankesat për diskriminim. Komunitat, si: Drenas, Gjilan, Ferizaj, Lipjan, Istog, si dhe disa ministri kanë deklaruar se mbajnë regjistra. Disa institucione e kanë konsideruar shkresën e Avokatit të Popullit (përmes së cilës janë kërkuar informacione) si rekomandim dhe kanë theksuar se planifikojnë që në të ardhmen të krijojnë regjistra për rastet e diskriminimit.

Informacionet në faqet zyrtare për raportimin e rasteve të diskriminimit të Avokati i Popullit - Shumë institucione kanë raportuar se ende nuk kanë publikuar informacion në faqet e tyre zyrtare mbi mundësinë e paraqitjes së ankesave të Avokati i Popullit, për rastet e diskriminimit, siç kërkohet me LMD. Disa komuna (Drenas, Gjilan, Mamushë, Istog, Ferizaj) kanë përfshirë ose janë në proces të përfshirjes së këtyre informacioneve. Policia e Kosovës dhe disa agjenci janë në fazë ridizajnimi të faqeve të tyre elektronike, për t'i përfshirë këto elemente.

Perceptimi dhe qasja e institucioneve ndaj obligimeve sipas Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi - Disa ministri dhe komuna e shohin LMD-në si pjesë të integritetit institucional (kjo rezulton nga përgjigjet e MASHTI-t, komunave Ferizaj dhe Istog). Disa institucione trajtojnë diskriminimin vetëm në mënyrë formale, përkatësisht janë deklaruar se nuk kanë pasur raste të ankesave për diskriminim dhe nuk kanë mekanizma të qartë për mbrojtjen nga diskriminim. Por, ato e konsiderojnë obligim ligjor për të krijuar mekanizma të tillë në të ardhmen. Ndërsa një pjesë e konsiderueshme e institucioneve nuk kanë kthyer fare përgjigje, ose kanë deklaruar se nuk kanë mekanizma për mbrojtjen nga diskriminimi, gjë që tregon mungesë përkushtimi për zbatimin e detyrimeve që dalin nga Ligji për Mbrojtje nga Diskriminimi.

Në përgjithësi, situata tregon se, përderisa disa institucione kanë struktura dhe procedura funksionale për mbrojtje nga diskriminimi, mungesa e regjistrave të standardizuar, mungesa e informacionit publik dhe qasja e papërqendruar ndaj LMD-së reflektojnë nevojën për përmirësim të koordinuar dhe të unifikuar në nivel vendi, për të siguruar zbatim efektiv dhe transparencë të mbrojtjes nga diskriminimi.

Zbatimi i rekomandimeve të Raporti të vitit 2023 të Avokatit të Popullit

Raporti Vjetor për Zbatimin e LMD-së për vitin 2023 ka shpërfaqur mangësitë dhe defektet në strukturën institucionale, që pamundësojnë mbikëqyrjen sistematike të zbatimit të këtij ligji. Raporti ka rekomanduar që të gjitha institucionet që kanë detyrimin për të zbatuar LMD-së duhet të ofrojnë trajnime për personelin e tyre, në mënyrë që të njohin përmbajtjen e LMD-së dhe të kuptojnë përgjegjësitë e tyre. Të punësuarit në institucionet publike duhet të jenë të vetëdijshëm për rolin e Avokatit të Popullit në mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit dhe institucionet duhet të tregojnë gatishmëri për bashkëpunim gjatë këtij procesi. Një nga mangësitë kryesore të identifikuar është mungesa e një sistemi të organizuar për mbledhjen e të dhënave mbi rastet e diskriminimit. Raporti i vitit të kaluar rekomandoi që institucionet të krijojnë një sistem të qëndrueshëm për mbledhjen dhe klasifikimin e këtyre të dhënave, duke përfshirë të dhëna të ndara për bazat dhe format kryesore të diskriminimit, që do të mundësojnë monitorim më efektiv nga Avokati i Popullit. Gjithashtu, raporti theksoi nevojën për përfundimin e emërimeve të zyrtarëve dhe funksionalizimin e njësive për mbrojtjen nga diskriminimi në ministri dhe komuna brenda 12 muajve të ardhshëm. Personeli i institucioneve duhet të trajnohet gjithashtu për mbledhjen e të dhënave në mënyrë që të mundësohet mbikëqyrja e zbatimit të Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Nga të dhënat dhe informacionet e Avokatit të Popullit, rezulton se shumica e rekomandimeve të raportit të vitit të kaluar nuk janë adresuar, duke përfshirë krijimin e një sistemi të etabluar për regjistrimin/mbajtjen e të dhënave për diskriminim në institucionet gjegjëse; mosplotësimi i strukturës institucionale; mostrajnimi i personelit përgjegjës për mbrojtjen nga diskriminimi në institucione.

Duhet theksuar se rekomandimi i raportit të vitit të kaluar për rritjen e bashkëpunimit të institucioneve të tjera me Avokatin e Popullit, në lidhje me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, është adresuar në draftin e ri të këtij ligji, i cili është pjesë e agjendës legjislative të Kuvendit të Republikës së Kosovës në vitin 2026.

VII. REKOMANDIMET

- Të gjitha institucionet që kanë detyrime specifike nga Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi të hartojnë plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit, të paraqitura në raportet vjetore të dorëzuara në Kuvendin e Republikës së Kosovës.
- Gjatë procesit të ndryshim-plotësimit të Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, të përcaktohen qartë mekanizmat e zbatimit të ligjit, kompetenca dhe përgjegjësitë, duke i ndarë mekanizmat për promovim dhe vetëdijësim, mekanizmat mbrojtës, të cilat mund të marrin ose të pranojnë ankesa, përfshirë ato administrative dhe gjyqësore.
- Të gjitha autoritetet publike, si institucionet në nivel qendror, ashtu edhe ato lokale, si dhe agjencitë e pavarura, të funksionalizojnë njësitë për mbrojtje nga diskriminimi ose të emërojnë pa vonesë zyrtarët për mbrojtje nga diskriminimi. Gjithashtu, të standardizojnë përshkrimin e detyrave të punës së tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi, dhe të mbajnë evidencën e rasteve që lidhen me pretendimet për diskriminim.
- Të qartësohet roli i Zyrës për Qeverisje të Mirë (ZQM) në promovimin dhe koordinimin e zbatimit të Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, brenda kompetencave të saj ligjore.

- Të organizohen trajnime për personelin e njësive dhe zyrtarët përgjegjës për të drejtat e mbrojtjes nga diskriminimi, lidhur me kuptimin dhe zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, si dhe për rolin mbikëqyrës të Avokatit të Popullit.
- Gjykatat dhe prokuroritë themelore të mbajnë të dhëna të ndara, regjistra dhe evidencë për rastet e diskriminimit, duke i integruar në SMIL, si dhe të ndryshojnë sistemin e klasifikimit të rasteve në mënyrë që rastet e diskriminimit të dallohen qartë nga rastet e tjera.
- Institucionet publike të sigurojnë publikimin e qartë, në faqet e tyre zyrtare, të procedurave për paraqitjen e ankesave te Avokati i Popullit, si dhe të ndërmarrin nisma për promovimin dhe vetëdijesimin e publikut në fushën e diskriminimit.